

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5780
E shtunë, 18 maj 2019
çmimi 0.40 €

Shoqëria civile kërkon tërheqjen e Projektligjit për financimin e subjekteve politike

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

NUK NDIHMOJNË REZOLUTAT E AS TRIBUNALET, SERBIA DUHET TË PADITET NË TË GJITHA ANËT

F.6

Nga Musa SABEDINI



OKUK-ja DO TË BËHET ME PARKING TË RI

F.7

PRESIDENTI THAÇI NDAU URDHRIN 'HERO I KOSOVËS' PËR ATDHETARIN RIFAT BERISHA

F.7

EKONOMI

PROMOVHET GUIDA TURISTIKE PËR KOSOVËN NË HOLANDISHT

F.9

FUQIZIMI I AGJENCISË SË METROLOGJISË, I RËNDË-SISHËM PËR PËRMIRËSIMIN E JETËS SË QYTETARËVE

F.8

KULTURË

'BISEDË PËRMES HEKURASH'

F.13

Prof. asoc. dr.
Shkelqim MILLAKU



SPORT

MBI 20 MILIONË EURO VETËM PËR KËSHILLTARË TË PROJEKTIT 'KOSOVA E RE'

F.12

FLET PËR "EPOKËN E RE", ISMET SALIHU

FAQE 4-5

Të rihapet Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës

Profesori i së Drejtës Penale Ndërkombëtare, Ismet Salihu, ka kërkuar rihapjen e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës të cilin e ka drejtuar më herët. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se vetëm një institut shkencor mund ta bëjë mbledhjen e fakteve të luftës dhe jo një komision shtetëror. Ai e ka mbështetur iniciativën e kryeparlamentarit Kadri Veseli për themelimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe duke thënë se një gjë e tillë është e mundshme. Sipas tij, kjo arrihet duke u dëshmuar kancelarive të botës prova të forta për krime. Megjithatë, Salihu ka treguar se, nëse nuk arrihet themelimi i këtij tribunal, atëherë gjykatat tona duhet t'i dënojnë krimet e luftës

Nesër votohet në veri, KQZ-ja bën thirrje për zgjedhje të lira



Qytetarët e katër komunave në veri të vendit nesër (e diel) do t'u drejtohen kutive të votimit për t'i zgjedhur kryetarët e tyre. Të drejtën e votës në këto zgjedhje mund ta shfrytëzojnë 57 983 qytetarë në 44 qendra të votimit, përkatësisht në 87 vendvo-

time. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë kanë bërë thirrje për zgjedhje të lira dhe demokratike. Ky proces zgjedhor do të vëzhgohet nga 464 vëzhgues të akredituar

FAQE 3

Brovina kërkon falje për fotografinë dhe pranon se mund të jetë e falsifikuar

FAQE 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Ministri Tahiri: Secili përgjegjës për krimet e luftës do të dalë para drejtësisë

PRISHTINË, 17 MAJ (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, pas ekstradimit të një të dyshuari për krime lufte nga Hungaria në Kosovë, ka ritheksuar se barazia para ligjit do të vlejë për të gjithë. Sipas ministrit Tahiri, rendi juridik i Kosovës garanton respektimin e dinjitetit dhe të drejtave të secilës palë në procedurë. "Sot institucionet tona kanë realizuar

ekstradimin nga Hungaria të një individi të dyshuar për krimet e luftës në Kosovë. Kemi dhënë garanci të plota se, krahas ballafaqimit me përgjegjësinë, ne do ta respektojmë dinjitetin dhe të drejtat e secilës palë në procedurë. Ka qenë përkushtimi vazhdueshëm dhe ne do të mbetemi të përkushtuar edhe më tej që secili përgjegjës për krimet e

luftës ndaj popullatës civile që kanë ndodhur në Kosovë gjatë viteve 1998-1999 do të dalë para drejtësisë dhe të përgjigjet për veprimet e veta", ka thënë Tahiri.

Ai ka shtuar se konsolidimi i bazës ligjore dhe rritja e kapaciteteve të organeve të sistemit të drejtësisë është bërë pikërisht për ta rritur efikasitetin e vendosjes së drejtësisë

për viktimat e këtyre krimeve. "Republika e Kosovës dhe rendi juridik i saj janë të mishëruara mbi bazën e parimeve më të shëndosha demokratike dhe atyre të drejtësisë. Zbatimi i të drejtave të njeriut, barazia para ligjit dhe secili segment që ndërlidhet me personat e dyshuar potencial për vepra penale, përfshirë edhe për ato që ndërlidhen me



krimet e luftës, vlejë dhe do të vlejë gjithnjë", ka deklaruar ministri Tahiri.

Limaj: Angazhimi i Gjermanisë në dialog na ofron siguri

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, pas takimit që ka pasur në Berlin me deputetin Johann Wadepful, ka theksuar se angazhimi i Gjermanisë në dialogun Kosovë - Serbi për ne është shumë i rëndësishëm dhe na jep siguri dhe ngrit seriozitetin



PRISHTINË, 17 MAJ - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, pas takimit që ka pasur në Gjermani me deputetin Johann Wadepful, i cili është edhe nënkryetar i fraksionit CDU-CSU dhe raportues për Ballkanin Perëndimor, në një konferencë për medie ka bërë me dije se me të kanë biseduar rreth mbajtjes së Samitit të Berlinit si dhe tema të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me dialogun dhe liberalizimin e vizave. "Kemi biseduar rreth Samitit të Berlinit dhe Samitit të Parisit që pritet të mbahet së shpejti. Në takim kemi biseduar për tema me rëndësi siç është çështja e taksës, dialogut me

Serbinë e tema të tjera. I sigurova edhe një herë në emër të Qeverisë që ne duam ta përmbyllim çështjen e dialogut me Serbinë", ka thënë zëvendëskryeministri Limaj. "Në Samitin e Berlinit janë larguar nga tavolina të gjitha idetë që nuk ndihmojnë në zgjidhjen e problemit", ka thënë Limaj në një konferencë për medie.

Ai ka theksuar se angazhimi i Gjermanisë në dialogun Kosovë - Serbi jep siguri. "Në Samitin e Berlinit e kemi pasur një mundësi për zhblllokim dhe heqjen nga tavolinat të ideve që nuk ndihmojnë në zgjidhjen e problemit dhe besoj se takimi i

Parisit do të përgatitet edhe më mirë. Angazhimi i Gjermanisë për ne është shumë i rëndësishëm dhe na jep siguri dhe ngrit seriozitetin", ka thënë Limaj.

Në fund, zëvendëskryeministri Limaj ka thënë se beson se shumë shpejt do të marrë fund çështja e liberalizimit të vizave.

Ndërsa në një bisedë për "Kosovapress", zëvendëskryeministri Limaj ka thënë se shpreson që edhe shteti gjerman do të ndikojë në politikën e Beogradit që të heqë dorë nga gjuha luftënxitëse, të pranojë dhe të distancohet nga krimet që ka bërë regjimi i Millosheviqit dhe të krijohet klima për të filluar një dia-

log të mirëfilltë Kosovë - Serbi. Limaj ka udhëtuar të premten për në Gjermani, ku pritet të zhvillojë edhe takime të tjera të rëndësishme. Kjo vizitë e Limajt po ndodh vetëm disa ditë pas mbajtjes së Samitit të Berlinit të organizuar nga kancelaria gjermane Angela Merkel dhe presidenti francez Emmanuel Macron.

Basha në Parlamentin britanik: Vendi ndodhet në krizë të rrezikshme!



TIRANË, 17 MAJ - Gjatë vizitës së punës në Londër, kryetari i Partisë Demokratike dhe delegacioni që e shoqëron u prit nga kryetari i Komisionit për Punët e Jashtme në Parlamentin Britanik, Tom Tugendhat. Në këtë takim, sipas Zyrës së Shtypit të PD-së, lideri i opozitës konfirmoi angazhimin e Partisë Demokratike dhe të gjithë

opozitës së bashkuar për një zgjidhje politike të krizës, që do të garantojë zgjedhje të lira dhe të ndershme, duke ndarë politikën nga krimi, duke i zgjidhur duart drejtësisë që t'i vërë para ligjit politikanët e përfshirë në shitblerje votash me krimin e organizuar si dhe afëra të tmerrshme korruptive. "Reformë e thellë politike për

fuqizimin e rolit të qytetarit sipas praktikave më të mira të vendeve demokratike perëndimore është angazhimi ynë", theksoi Basha. Gjithashtu, Basha e falënderoi Tugendhat për qëndrimin e qartë dhe të prerë të Britanisë së Madhe dhe Parlamentit Britanik kundër ndryshimit të kufijve dhe copëtimit të Kosovës, çka do të ishte

një precedent i rrezikshëm kundër paqes dhe stabilitetit në Ballkan.

Gjatë takimit u diskutua mbi prioritetet e bashkëpunimit të ardhshëm midis Shqipërisë dhe Qeverisë britanike në fushat e bashkëpunimit strategjik të sigurisë kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.

Presidenti Meta u kërkon partive ta shmangin konfrontimin civil

TIRANË, 17 MAJ - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, u bëri thirrje partive kryesore politike të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme në këtë situatë të trazuar dhe ta zgjidhin krizën politike.

Presidenti Meta tha se mazhoranca dhe opozita duhet të jenë

të përgjegjshme dhe të vetëdijshme për pasojat që i presin, nëse ndodh që vendi të shkojë në konfrontim civil. "Kjo situatë nuk duhet të ekzistonte kurrësi pas 22 vjetësh qëkur Shqipëria u nda në vitin 1997, që ishte një vit mjaft fatkeq. Të gjithë t'i thërrasin mendjes dhe t'i marrin

përgjegjësitë e tyre. Për interesa tërësisht egoiste dhe okulte Shqipëria nuk ka pse të shkojë në konfrontim dhe as shqiptarët. Ata kanë vendosur të bashkëjetojnë në mënyrë demokratike dhe janë ndarë nga sistemet përjashtuese që në vitin '90", tha presidenti Meta.


Ai tha se askush nuk mund t'i hedhë përgjegjësitë te të tjerët, aq më pak te presidenti i Republikës. "Ata e dinë vetë shumë mirë se çfarë duhet të bëjnë dhe duhet të jenë të ndërgjegjshëm për pasojat që do të kenë në rast se e çojnë vendin drejt konfrontimit", tha Meta.



Të dielën mbahen zgjedhjet për kryetarë në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut

Nesër votohet në veri, KQZ-ja bën thirrje për zgjedhje të lira

Qytetarët e katër komunave në veri të vendit nesër (e diel) do t'u drejtohen kutive të votimit për t'i zgjedhur kryetarët e tyre. Të drejtën e votës në këto zgjedhje mund ta shfrytëzojnë 57 983 qytetarë në 44 qendra të votimit, përkatësisht në 87 vendvotime. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë kanë bërë thirrje për zgjedhje të lira dhe demokratike. Ky proces zgjedhor do të vëzhgohet nga 464 vëzhgues të akredituar



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 17 MAJ - Nesër (e diel) do të mbahen zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Leposaviqit, Komunës së Zubin Potokut, Komunës së Zveçanit dhe Komunës së Mitrovicës së Veriut. Të drejtën e votës në këto zgjedhje mund ta shfrytëzojnë 57 983 qytetarë në 44 qendra të votimit, përkatësisht në 87 vendvotime.

Procesi zgjedhor i së dielës do të vëzhgohet nga 464 vëzhgues të akredituar të cilët përfaqësojnë dy parti politike, dy misionet ndërkombëtare, një komision evropian, dy misione diplomatike, dymbëdhjetë ambasada, një OJQ ndërkombëtare, katër OJQ vendore dhe pesëmbëdhjetë media.

Fushata pesëditore për zgjedhjet e jashtëzakonshme në veri ka përfunduar mbrëmjen e së premtes.

Tashmë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i ka bërë përgatitjet e nevojshme për t'i orga-

nizuar zgjedhjet e jashtëzakonshme në veri.

Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, u ka bërë thirrje qytetarëve të marrin pjesë në këtë proces zgjedhor dhe t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre. Po ashtu, ajo ka kërkuar nga subjektet politike dhe kandidatët e tyre, që t'u përmbahen ligjeve të Republikës së Kosovës dhe rregullave zgjedhore.

Daka ka theksuar për gazetën "Epoka e re" se nuk pret parregullsi në zgjedhjet e 19 majit meqë Kosova tashmë ka krijuar kulturë zgjedhore. "Organizimi i zgjedhjeve në veri nuk do të jetë sfidë. Deri më tash KQZ-ja ka mbajtur disa herë zgjedhje në pjesën veriore të Kosovës, prandaj konsideroj se nuk do të kemi ndonjë telashe në këtë drejtim sa i përket anës së organizimit dhe mbajtjes së zgjedhjeve të 19 majit në veri. Tashmë kemi bërë përvijë edhe në atë pjesë të Kosovës dhe besoj se çdo gjë do të shkojë në rregull. Unë pres që zgjedhjet e 19 majit të shkojnë mirë dhe qytetarët t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre për kryetarë

të komunave ata që mendojnë se janë më të mirët. Shpresoj se i gjithë procesi zgjedhor do të shkojë në rregull, duke e anashkaluar pjesën politike", ka deklaruar Daka, duke shtuar se KQZ-ja bën thirrje për zgjedhje të lira, fer dhe demokratike.

Edhe shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Natalya Apostolova, nëpërmjet një deklarate për medie ka kërkuar zgjedhje të lira dhe demokratike në veri. "Zgjedhjet transparente, gjithëpërfshirëse dhe të besueshme që ofrojnë një përzgjedhje domethënëse të kandidatëve janë themeli i demokracisë", është thënë në deklaratën e Apostolovës. Ajo ka thënë se BE-ja pret që të gjithë aktorët e përfshirë në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë

në katër komunat në veri të Kosovës ta respektojnë integritetin e procesit zgjedhor. "BE-ja thekson rëndësinë e respektimit dhe zbatimit të rekomandimeve të misionit vëzhgues të BE-së nga zgjedhjet e kaluara. Puna duhet të bëhet në përputhje me marrëveshjen e fundit të arritur në mes të gjitha partive politike në Kuvend", është theksuar më tutje në këtë deklaratë.

Në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të katër komunave në veri garojnë Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lista Serbe.

Kandidate e PDK-së për kryetarë të Mitrovicës së Veriut është Gonxhe Caushi, kandidat për kryetar të Leposaviqit është

Shaqir Hetemi, kandidat për kryetar të Zveçanit është Ilir Peci dhe Hysen Mehmeti është kandidat për kryetar të Zubin Potokut. Ndërsa kandidatja e Lëvizjes Vetëvendosje për Komunën e Zubin Potokut është Liridona Kahrmani, kandidat për kryetar të Komunës së Leposaviqit është Fisnik Veseli, kandidat për kryetar të Komunës së Zveçanit është Avdi Peci si dhe kandidat për kryetar të Komunës së Mitrovicës Veriore është Erden Atiqi.

Kurse kandidati për kryetar të Komunës së Leposaviqit nga Lista Serbe është Zoran Todiq, për kryetar të Zubin Potokut Srdjan Vuloviq, për kryetar të Zveçanit Vuçina Jankoviq si dhe për Mitrovicë të Veriut Goran Rakiq.

QKUK-ja do të bëhet me parking të ri

PRISHTINË, 17 MAJ (ER) - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) ka njoftuar se shumë shpejt do të zgjidhet çështja e parkingut për personelin dhe vizitorët e pacientëve që frekuentojnë ambientet e saj. "Punimet për parkingun e ri, i cili po shtrihet në pjesën jugore të oborrit të QKUK-së, pas Klinikës së Ortopedisë, pritet të përfundojnë brenda pak javësh. Parkingu i ri parashihet të ketë rreth 400 vendparkingje, me këtë investim tollovitë e krijuara për vite me radhë brenda ambienteve të QKUK-së do të marrin fund", është thënë në njoftimin për media.

Në këtë njoftim është theksuar se si rezultat i menaxhimit efikas, të hyrat nga laurat (hyrjet) në QKUK janë rritur për 400 për qind, duke i dhënë mundësinë për më shumë investime në infrastrukturë, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për pacientët dhe stafin shëndetësor.



Flet për "Epokën e re", Ismet Salihu

Të rihapet Instituti për Hulumtimet



Profesori i së Drejtës Penale Ndërkombëtare, Ismet Salihu, ka kërkuar rihapjen e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës të cilin e ka drejtuar më herët. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se vetëm një institut shkencor mund ta bëjë mbledhjen e fakteve të luftës dhe jo një komision shtetëror. Ai e ka mbështetur iniciativën e kryeparlamentarit Kadri Veseli për themelimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe, duke thënë se një gjë e tillë është e mundshme. Sipas tij, kjo arrihet duke u dëshmuar kancelarive të botës prova të forta për krime. Megjithatë, Salihu ka treguar se, nëse nuk arrihet themelimi i këtij tribunal, atëherë gjykatat tona duhet t'i dënojnë krimet e luftës

Pastaj duhet të bëhen vëllime me emrat e të gjithë të vrarëve gjatë luftës. Kapitull i veçantë i krimeve të luftës duhet të jenë masakrat, ku duhet të evidentohej të gjitha masakrat që kanë ndodhur dhe emrat e të masakruarve. Fjala masakër do të thotë vrasje masive e njerëzve të pafajshëm. Po ashtu, kapitull i veçantë duhet të jenë personat e zhdukur, dëmet materiale, eksodi apo shpërngulja me dhunë që u është bërë shqiptarëve gjatë luftës. Natyrisht se duhet të ndodhë edhe ajo që kam propozuar unë, të themelohet edhe Muzeu i Krimeve të Luftës.

Në atë muze duhet të ekspozohen të gjitha faktet dhe fotografitë e luftës. Pastaj, të dhënat e mbledhura në atë institut duhet të publikohen në gjuhën shqipe dhe angleze. Nëse ka nevojë, edhe në gjuhën serbe. Krahas botimit në letër, këto të dhëna duhet të publikohen edhe në mënyrë digjitale. Krahas punës së institutit, duhet që në shtatë regionet e Kosovës të emërohen nga dy prokurorë për hulumtimin dhe ngritjen e akuzave për krime luftime. Dy prokurorë nuk mund ta kryejnë këtë punë. Në aspektin juridik penal të ndjekjes, gjykatat ndërkombëtare dhe

vendore nuk mund të zhvillojnë procedurë dhe ta shpallin dikë fajtor në bazë të fjalëve. Për këtë duhet prova. Pra, krahas punës së institutit për faktimin dhe evidentimin e provave të luftës, duhet të punojnë edhe organet e drejtuesit, policia, prokuroria dhe gjykatat. Duhet të shkohet paralelisht me këtë çështje.

"Epoka e re": Sa vështirë do të jetë mbledhja e këtyre fakteve, 20 vjet pas luftës?

Salihu: Do të bisedoj edhe me z. Veseli dhe do t'i them se komisioni i cili është propozuar nuk mund t'i mbledhë faktet e luftës. Këtë punë duhet ta kryejë instituti, pra individët profesionalë. Për çdo respekt për përfaqësuesit e shoqatave të të zhdukurve dhe të viktimave, por mbledhja e fakteve të luftës është punë e profesionistëve. Në vitin 1991, me dekret të veçantë ish-kryetari i Bosnjës, Alija Izetbegović, e ka themeluar Institutin për Krime të Luftës, i cili ende është duke e vazhduar sot punën. Të dhënat që do t'i mbledh instituti mund t'i shfrytëzojnë pastaj prokurori dhe policia.

"Epoka e re": Kosova e ka pasur Institutin për Hulumtimin e

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 17 MAJ

"Epoka e re": Profesor, Kuvendi i Kosovës, ndonëse me vonesë, ka arritur ta miratojë rezolutën për gjenocidin serb në Kosovë?

Salihu: Rezoluta është me vend në aspektin human dhe njerëzor dhe është një lloj satisfaksioni për familjarët e viktimave të kësaj luftime. Miratimi i kësaj rezolute, edhe pse me vonesë, më mirë vonë se kurrë.

"Epoka e re": Z. Veseli ka ndërmarrë një iniciativë për mbledhjen e provave të luftës në mënyrë që të bëhet krijimi i një tribunalit ndërkombëtar për Serbinë. Si e keni parë këtë iniciativë?

Salihu: Kjo iniciativë duhet të

mbështetet nga institucionet dhe gjithë të tjerët. Në 20 vjetët e fundit ky është njeriu që më së tepërmi tani ka filluar një punë shumë të rëndësishme dhe serioze, të cilën e bënë çdo udhëheqës i kombeve pas luftës. Kjo është dashur të bëhet më herët, ani pse duket pak ideale me angazhimin e resurseve humane dhe profesionale të cilat i ka Kosova në aspektin profesional. Kjo punë mund të kryhet për katër ose pesë vjet.

"Epoka e re": Iniciativa e Veselit parasheh që Kuvendi ta formojë edhe një komision shtetëror për krijimin e tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë. Si duhet të jetë ky komision?

Salihu: Në këtë proces duhet të

evidentohen, të shënohen dhe të sistemohen së pari të gjitha viktimat njerëzore, vrasjet, torturat dhe kampet e përqendrimit. Sa i përket komisionit, mendoj se urgjentisht duhet të rihapet Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës. Në atë institut të mos punësohen individë në baza partiake, por vetëm individë të ri dhe profesionalë, të cilët do ta kenë detyrë që t'i evidentojnë provat e luftës. Në çdo shtëpi, në çdo fshat, ku ka ndodhur krimi, duhet të shkohet dhe të shënohet emri dhe mbiemri i viktimës, të sigurohet fotografia e tij nëse është e mundshme dhe me tri ose katër fjali të shkruhet se si është vrarë ajo viktimë, ku është vrarë, dhe nëse dihet kush e ka vrarë.

Hulumtimin e Krimeve të Luftës



Krimeve të Luftës, të cilin e keni udhëhequr ju dhe profesori Zejnullah Gruda. Çfarë keni bërë gjatë asaj kohe?

Salihu: Ai institut është themeluar në qershor të vitit 2011 me propozimin e profesorit Hajredin Kuçi, i cili ishte edhe ministër i Drejtësisë. Tek një vit pas themelimit kemi arritur të kemi zyrë, për të cilën qira kemi paguar 900 euro në muaj. Aty kemi punuar gjashtë vjet, ndërsa shtatë veta kemi qenë të punësuar. Gjatë asaj kohe kemi bërë pyetësorin për hulumtimin në terren dhe me prioritet filluam t'i mbledhim të dhënat për vrasje, për personat e pagjetur, për shkatërrimin e trashëgimisë kulturore dhe për shkatërrimin e arkivave. Në këtë drejtim punuam dhe kemi bërë tetë botime në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Brengosëse për neve ka qenë se nuk na është lejuar dhe nuk kemi financuar që të bëjmë hulumtime në terren. Pra, nuk na është lejuar të paguajmë studentët ka 10 - 15 euro në ditë që të mbledhin fakte në terren. Unë mund të dalë një herë në javë apo një herë në muaj në terren, më shumë nuk ma mundëson mosha.

Në vitin 2017, me pretekst se

Qeveria ka marrë vendim që të mos paguajë qira, ne u larguam prej ndërtesës që i kishim pesë zyra dhe na dërguan në dy zyra te kontejnerët mbrapa ish-"Rilindjes", ku mezi e kemi akomoduar arkivin. Ndërsa në korrik të vitit 2018, me vendim të këtyre kompetentëve, instituti i cili kishte punuar në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë shndërrohet në Departament për Drejtësi Tranzicionale. Në këtë departament është paraparë që të punojnë tre veta për krime të luftë dhe tre veta të tjerë për krime të rëndomta. Në këtë mënyrë, faktikisht është mbyllur instituti ende pa e kryer punën e tij. E kam thënë edhe më herët dhe po e përsëris prapë, se nëse nuk e bëjmë evidentimin e saktë të viktimave, do ta bëjmë krimin e sërishëm ndaj viktimave. Për këtë nuk është tash fajtorë Serbia, por ne.

"Epoka e re": Disa deputetë ju kanë kritikuar se instituti nuk ka punuar sa duhet?

Salihu: Në kushtet në të cilat kemi punuar kemi bërë maksimumin në këtë drejtim. Përveç gjërave që thashë më lart, ne kemi organizuar dhjetë ekspozita për krime të luftës.

Disa në Prishtinë, dy apo tri të tjera në Shqipëri, pastaj në Turqi dhe Austri.

"Epoka e re": Qëllimi i gjithë kësaj iniciative është që pas mbledhjes së të dhënave të synohet themelimi i një tribunali ndërkombëtar për krimet e luftës në Kosovë. Sa do të jetë sfiduese kjo?

Salihu: Mbledhja e fakteve nga rithemelimi i institutit dhe puna e institucioneve të drejtësisë duhet të na çojë kah themelimi i një gjykate penale ndërkombëtare. Natyrisht se në këtë drejtim duhet të punojnë edhe gjykatat tona, duhet të punojnë në dënimin e këtyre krimeve. Nëse presim vetë themelimin e një gjykate ndërkombëtare për dënimin e këtyre krimeve, nuk mund të bëhet ndonjë gjë e madhe. Themelimi i kësaj gjykate do të jetë sfiduese, sensitive, e ndjeshme dhe komplekse por, nuk përjashtohet. Nëse ne punojmë, mbledhim fakte dhe ato ua prezantojmë kancelarive të Evropës dhe botës, atëherë mund të krijohet baza apo platforma e themelimit të kësaj gjykate. Por, nëse nuk mund ta arrijmë këtë, gjykatat tona duhet t'i dënojnë ato krime.

Brovina kërkon falje për fotografinë dhe pranon se mund të jetë e falsifikuar

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 17 MAJ - Deputetja e Kuvendit të Kosovës, Flora Brovina, e cila të enjten ka publikuar një fotografi, të cilën fillimisht e ka prezantuar si dëshmi të akteve të përdhunimeve seksuale gjatë luftës në Kosovë, ka pranuar të premten se kjo fotografi mund të jetë e falsifikuar. Sipas saj, këtë fotografi, të cilën ajo e ka publikuar para mediave, e kishte marrë qysh në vitin 2003 nga një zyrtarë e Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Prishtinë dhe e ruante si "dëshmi për krimet e kryera nga forcat e Serbisë në Kosovë". "Nga viti 2003 këtë dokument e ruaj në mesin e shumë dokumenteve të tjera dhe tani, pas kaq kohësh, të quhet ky dokument i falsifikuar, më vjen shumë keq. Edhe një herë u kërkoj falje të gjithë atyre dhe qëndroj prapa për fajësinë time që nuk e kam verifikuar në momentin e fundit", ka thënë Brovina, duke shtuar se kurrë nuk ka menduar se dikush

mund t'i sjellë dokumente të paverifikuara. Këto komente Brovina i bëri pas ofrimit të dëshmisë në Prokurorinë Speciale të Kosovës.

Deputetja Brovina ka thënë se është e gatshme të dëshmojë për të gjitha kërkesat e Prokurorisë. "Andaj, nuk kam besuar se ky dokument nuk mund të jetë i saktë", ka thënë Brovina pas raportimeve se fotografia që ajo kishte ofruar si dëshmi nuk ishte realizuar fare në Kosovë. Fotografia e publikuar të enjten gjatë punimeve të Kuvendit të Kosovës si dëshmi e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë është pamje e cila duket se është marrë nga faqe interneti me përmbajtje pornografike. Mediat vendore në Kosovë kanë publikuar pamjet e njëjta, duke u thirrur në faqet e internetit për të rritur.

Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar se ka nisur hetimet lidhur me fotografinë të cilën deputetja Brovina ua ka prezantuar mediave, për të cilën ajo kishte theksuar se është dëshmi e dhunës seksuale ndaj një grua-



je 35-vjeçare nga ana e ushtarëve serbë gjatë luftës në Kosovë.

Prokurorja e Prokurorisë Speciale të Kosovës, Drita Hajdari, ka theksuar se publikimi i fotografisë nga deputetja Brovina ka shkaktuar shqetësim të madh në opinion. Por, ajo ka hedhur poshtë pohimet e

mëhershme të deputetes Brovina se Prokuroria ka qenë në dijeni lidhur me fotografinë që ajo ka prezantuar në Kuvendin e Kosovës. Ajo ka thënë se Brovina i ka thënë Prokurorisë se deri te posedimi i fotografisë ka ardhur në vitin 2003 përmes disa aktivistëve nga Gjakova, emrat e të cilëve nuk i mban

mend. "Në pyetjen time se a e ka raportuar rastin në prokurori ose në polici, meqë kemi të bëjmë me vepër penale, ka deklaruar që jo dhe se nuk ka njohuri që ka për obligim ta deklarojë rastin në prokurori. Po ashtu, ka shprehur shqetësim me daljen e informatave, se kjo foto mund të jetë nga lufta e Irakut dhe se ajo nuk ka një njohuri të tillë", ka thënë Hajdari. Sipas saj, intervistimi i deputetes Brovina, në cilësinë e dëshmitares, nga ana e Prokurorisë Speciale, është vetëm një hap hetimor.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, njëherësh kryetar i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka mbajtur një konferencë për medie, në të cilën ka folur për skandalin lidhur me publikimin e një fotografie të falsifikuar si dëshmi për dhunimet në Kosovë nga deputetja e kësaj partie, Flora Brovina, në seancën e së enjtes. Ai ka thënë se Flora ka bërë gabim të rëndë por, sipas tij, pa dashje. Madje Veseli ka thënë se duhet të nxirret një mësim i mirë nga ky gabim i deputetes së PDK-së.

Nuk ndihmojnë rezolutat e as tribunalet, Serbia duhet të paditet në të gjitha anët



Nga Musa SABEDINI

Klasa politike në Kosovë është zgjuar nga gjumi njëzet vjet pas luftës, sepse deri më tani ishte e zënë pas hajnisë. Edhe sikur të themelohen tribunale të shumtë, edhe sikur të aprovohen dhjetëra rezoluta, rezultati do të jetë zero nëse nuk aktivizohen prokuroritë nëpër komuna dhe Prokuroria Speciale. Ka qindra dosje që janë deponuar edhe zyrtarisht, ka dhjetëra materiale arkivore, me dëshmi të gjalla që ndodhen të deponuara nëpër prokuroritë themelore, por kurrë dhe asnjëherë nuk janë hetuar. Sistemi i drejtësisë është i krimbur.

Shumë pluhur u ngrit për këtë Tribunalin për krimet serbe, shumë pluhur për një Rezolutë të vetme që dënon gjenocidin dhe krimet serbe, shumë pluhur të panevojshëm për një foto të Flora Brovinës, shumë pluhur prej një grupi të caktuar të njerëzve që kurrë s'kanë

dashur të hetohet Serbia dhe nuk duan as sot e asaj dite.

Serbia i ka borxh shumë Kosovës, për Serbinë çfarëdo që shkruan ose flet nuk koritësh. Krimet janë evidente, masakrat janë të ditura botërisht, dhunimet gjithashtu, vrasjet e rënda, vrasjet e shumta, dëmet materiale dhe shumë. Serbia e ka goditur dhe lënduar Kosovën në të gjitha aspektet.

Jo rastësisht Serbia, e cila së bashku me ushtrinë e saj, e ndihmuar nga paramilitarët serbë dhe policia kanë vrarë në mënyrë të organizuar fëmijë, nxënës, studentë, bujq, imamë, shurdhmemecë, rojtarë, zjarfikës, profesorë, drejtor shkollash, minatorë, taksistë, amvise, juristë, inxhinierë, kamerierë, gazetarë etj.

I janë dashur kësaj klase politike hiq më pak se njëzet vjet që të zgjohet nga gjumi dhe të kërkojë drejtësi. "Duhet të dënohen kriminelët serbë dhe të sillen para drejtësisë", ky ishte slogan i krerëve shtetërorë, definitivisht qesharak dhe të vonuar. Qesharak, sepse tashmë shumë dëshmitarë kanë vdekur ose janë të sëmurë rëndë dhe pa asnjë përkrahje nga shteti, qesharak sepse shumë serbë të dyshuar tashmë janë rehatuar

dhe, ose kanë vdekur, ose ndodhen në vende të sigurta.

Pra, faji është pak a shumë është kolektiv. Kur dikush shkruante për dhunimet dhe vrasjet e kryera nga paramilitarët serbë, të tjerët bënin sehir ose nuk donin ta prishnin rehatinë në raport me Serbinë. Edhe sot kur po lexoj e shoh se si po çirren një kategori e këtyre njerëzve, nuk befasohej aspak, sepse të tillët kurrë s'kanë dashur të hetohet Serbia.

Mosdëshkimi i krimeve serbe e ka detyruar Kosovën që ta ulë pazarin në të gjithë tavolinat e bisedimeve. Serbia, nga një shtet kriminal, në këto bisedime dilte paqësore. E dhimbshme kjo. Pse ndodhi kjo, është fare e lehtë, sepse klasa politike me dekada po organizohej për të vjedhur, plaçkitur pronat publike, për të bërë skema hajnie e vjedhje marramendëse. Thjesht, nuk kishte kohë të merrej me krimet që kishte bërë Serbia në Kosovë. Të gjitha qeveritë pa përjashtim, synonin punësimet partiake, mbushnin arkat e partive të tyre, ndërsa nuk ishin në gjendje që grave të dhunuara t'ua bënin një pagë dinjitoze. Jemi shoqëri me gynahe të mëdha dhe janë këto institucione që

kurrë historia nuk ka për t'ua falur. Por, mbi të gjitha, janë prokurorët ata që kanë gynahe ekstreme në këtë drejtim.

Janë qindra dosje, dokumente, arkiva, fotografi, deklarata, libra dokumentues, dëshmitarë të gjallë, që nuk u morën parasysh nga prokurorët vendorë. Pse atëherë po presim përkrahje nga jashtë, kur këta prokurorë ose këto prokurori nuk e kanë bërë asnjë fletë arrest të vetëm, që është më e pakta që ka mundur të bëhet.

Edhe po të aprovojmë për çdo ditë rezoluta, edhe po të kemi të formuar një tribunal për të hetuar krimet serbe, pak besoj që situata mund të ndryshojë. Sistemi i drejtësisë është i krimbur në palcë dhe në koncept. Në shumicën e prokurorive ende ka njerëz të klanit të Millosheviqit, të cilët kanë punuar që të bëjnë të pamundur deponimin e dëshmitarëve. Pastaj është e kot rritja e pagave për prokurorët apo gjykatësit, sepse të tillët janë mësuar me ngrënë në dy lugë. Krejt çka mbetet në këtë situatë, është mundësia që komunat të padisin Serbinë, secila në mënyrën e vetë. Secila komunë i ka të arkivuara shënime dhe të dhënat e luftës, janë emrat, regjistrat e serbëve

të dyshuar, ato vetëm duhet të faktohen në adresën e saktë.

E keqja është që shumë dëshmitarë janë të sëmurë ose disa prej tyre edhe kanë vdekur. Kjo është bërë edhe me qëllim të caktuar, sepse vdekja e dëshmitarit në njëfarë mënyre e zbehë dëshminë.

Pse po merret kjo shoqëri aq shumë me Flora Brovinën, vërtet është për t'u shqetësuar. Edhe nëse ajo ka gabuar dhe ka shkelur etikën me botimin e asaj fotografie, krimet serbe nuk humbin as nuk zhduken. Asnjë veprim i asnjë qytetari shqiptar nuk e minimizon gjenocidin serb mbi shqiptarët e Kosovës.

Uroj që Kosova dhe populli i saj të aktivizohet seriozisht, të përgatis materiale e dokumente të të gjitha llojeve dhe ta bëjë përgjegjës Serbinë, për krime, vrasje, dhunime, plagosje, dëmtim pasurie, vjedhje, plaçkitje dhe të gjitha këto të dorëzohen edhe njëherë nëpër prokuroritë vendore, kurse partitë politike që kanë bërë hetime paralele, është koha e fundit që t'i dorëzojnë ato materiale e arkiva se mjaft i kanë ruajtur nëpër sirtarë.

(Autori është gazetar dhe profesor i gazetarisë në UBT)

Presidenti Thaçi dha urdhrin 'Hero i Kosovës' për atdhetarin Rifat Berisha

PRISHTINË, 17 MAJ (ER) - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të premtën ka marrë pjesë në akademinë përkujtimore për heroin Rifat Berisha. Presidenti Thaçi ka thënë se në prag të njëzetvjetorit të çlirimit të Kosovës po e përkujtojnë një figurë të ndritur të historisë kombëtare, Rifat Berishën, nënkryetarin e Konferencës së Bujanit, nënkryetarin e Këshillit Antifashist të Kosovës. "Përcaktimi i drejtë jetësor, kombëtar dhe politik, gjithmonë e ka një bazament për çdo personalitet të lëvizjes kombëtare. Fshati Berishë ishte vendlindja e Tahir Berishës, xhaxhait të Rifatit, njërit nga njerëzit më të urtë dhe më të mençur që ka prodhuar gjeniu ynë popullor. Xhaxhai i tij ishte përhapës i librit shqip në kohën e errët të mbretërisë jugosllave, i lidhur me patriotët dhe intelektualët më të shquar të kohës, si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Shtjefën Gjeçovi dhe të tjerë", u shpreh presidenti Thaçi, duke shtuar se

burimi i parë i frymëzimit dhe edukatës atdhetare për Rifat Berishën ishte pikërisht ky burrë i matur dhe me shumë inteligjencë natyrore.

Kreu i shtetit theksoi se shkollimi në Shqipëri i forcoi edhe më shumë tiparet atdhetare dhe e skaliti karakterin e Rifat Berishës. "Rifat Berisha e kishte angazhim jetësor bashkimin me Shqipërinë", ka thënë ai.

Rifat Berisha, ndonëse deputet në nivel republikan dhe kryetar komisionesh ekzekutive, sipas presidentit Thaçi, nuk pranoi që të përpunohet dhe të thyhet asnjëherë. "Ai së bashku me disa atdhetarë krijuan Frontin Kombëtar Shqiptar, me synim që të organizojnë kryengritje popullore kundër regjimit komunist jugosllav. Duke parë që ai mbetej një atdhetar i pastër, duke parë ndikimin e tij në masat e gjera, pas vëzhgimit të gjatë, organet e pushtetit ushtarak përpunonin ta arrestojnë. Në fakt, 17 maji i vitit 1949 e tregoi qartazi fak-



tin se me çfarë ideali ishte rritur, edukuar dhe përcaktuar Rifat Berisha. Ai nuk do të dorëzohej i gjallë tek organet e OZNA-s. Përkundrazi, Rifati dhe bashkëluthtarët e tij besnikë, në

idealin për realizimin e të drejtave kombëtare, zgjedhën rezistencën e armatosur", ka thënë presidenti Thaçi.

Me këtë akademi Thaçi ka thënë se po ia bëjnë nderimet më të larta

institucionale këtij atdhetari dhe nacionalisti të palëkundshëm. Duke u bazuar në kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore, presidenti Thaçi dha urdhrin "Hero i Kosovës" për atdhetarin Rifat Berisha.

Shoqëria civile kërkon tërheqjen e Projektligjit për financimin e subjekteve politike

Njëqind organizata të shoqërisë civile kanë nisur fushatën për ta kundërshtuar Projektligjin për financimin e subjekteve politike nën moton "Paratë tona, standardet tona". Përfaqësues të shoqërisë civile kanë bërë me dije se do të nisnin takime me përfaqësues institucionalë si dhe do të organizojnë aktivitete të tjera për ta kundërshtuar këtë projektligj.



KQZ nuk duhet të jetë autoritet i kontrollit të financave të partive politike; dëmtojnë frymën kushtetuese të ligjit për shkak të dispozitave kontradiktore që rregullojnë marrëdhënien midis subjektit politik dhe deputetit për çështjen e fondit; cenonjë transparencën e subjekteve politike ndaj publikut pasi që mundësojnë mospublikimin e emrave të pronarëve të personave juridikë (kompanive) që japin kontribut për subjektet politike. Për më tepër, tavanet e kontributeve "në para të gatshme" për subjektet politike janë dhjetëfishuar (nga 50 në 500 euro), ndërsa kontributet e personave fizikë dhe juridikë në kohë fushate janë dyfishuar; dhe zvogëlojnë llogaridhënien e subjekteve politike ndaj publikut pasi që lejon zgjatje të afateve për publikim të raporteve financiare të fushatës. Po ashtu, gjobat për shkeljet e dispozitave ligjore nga subjektet politike janë zvogëluar deri në 75 për qind.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 17 MAJ - Shoqëria civile ka nisur fushatën për kundërshtimin e miratimit të Projektligjit për financimin e subjekteve politike, me moton "Paratë tona, standardet tona". Kjo fushatë po mbështetet nga 100 organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të cilave të premtën përmes një konference për media kanë bërë me dije se do të nisnin takime me përfaqësues institucionalë si dhe do të organizojnë aktivitete të tjera për ta kundërshtuar këtë projektligj.

Në konferencë u bë me dije se shumica e amendamenteve të propozuara nga grupi punues në kuadër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, për Projektligjin 06L-137 për Financimin e Subjekteve Politike, cenonjë standardet ndërkombëtare për financimin e partive politike, në veçanti rekomandimet e Komisionit të Venedikut që i janë dhënë Qeverisë së Kosovës përkitazi me këtë projektligj më 3 maj 2018.

Amendamentet e miratuara në lexim të dytë nga Komisioni për Buxhet dhe Financa e dëmtojnë projektligjin sepse cenonjë

pavarësinë e Zyrës për Regjistrimin e Subjekteve Politike duke ia hequr kësaj zyre mandatin për mbikëqyrjen e financave të partive politike, përfshirë shqiptimin e gjobave. Bartja e këtyre funksioneve në një trup politik si Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) bie ndesh edhe me rekomandimet

e Komisionit të Venedikut për forcimin e rolit të Zyrës; nuk adresojnë prioritetet e Agjendës për Reforma Evropiane (ERA) për të siguruar transparencë, llogaridhënie, zbatim dhe sanksione efikase në financimin e partive politike. Programi Kombëtar për zbatimin e MSA-së 2019 - 2023 e thotë qartë se

Haradinaj: Jabllanica pagoi çdo çmim për t'u thënë 'jo' forcave pushtuese

GJAKOVË, 17 MAJ (ER) - "Jabllanica e atëherëshme nuk ishte më vetëm shpresë, por u kthye në realitet, sepse kur ke hyrë aty ke qenë i mbrojtur dhe pikërisht për këtë nuk ka udhëheqës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që nuk i ka rënë të pushojë këtu, të vazhdojë për Shqipëri e të kthehet prapë këtu", ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në manifestimin përkujtimor me rastin e 20-vjetorit të çlirimit të Jabllanicës tash Shqiponjës, organizuar nën përkujdesjen e Zyrës së Kryeministrit.

Fillimisht, kryeministri Haradinaj ka bërë homazhe në Kompleksin Përkujtimor të Dëshmorëve në Shqiponjë të Gjakovës. Kryeministri Haradinaj gjatë fjalës së tij ka thënë se kjo datë që e kujtojnë sot është datë krenarie për shqiptarët, "pasi vendi në të cilin gjenden sot e ka dhënë provimin

vetë pa ndihmën e askujt ndër vite, duke iu thënë 'jo' forcave të armikut". "Ishte një rast unik, kur një vendbanim i vogël, zonë e varfër, kishte vendosur të jetojë vetë, pa u kyçur fare në pjesën tjetër të jetës, të paguajë çdo çmim për t'u thënë 'jo' forcave pushtuese", ka deklaruar kryeministri Haradinaj, duke shtuar se ai ishte një lajm trimëruar për bashkëkombësit kudo në botë.

Kryeministri Haradinaj gjatë fjalës së tij në këtë manifestim përkujtimor ka thënë se Jabllanica, tash Shqiponja, kishte guxim dhe bindjen, që dinte shumë mirë qëllimin e armikut dhe për këtë, ky vend u bë një mit për shqiptarët, duke shtuar se gjithmonë përmes kësaj adrese është zhvilluar gjithë ai proces i gjatë i përgatitjes dhe aftësimin të luftës.

Duke folur për sakrificën e shumë brezave të këtij fshati, të



cilët u bënë luftëtarë, duke u kthyer në prijës të luftës dhe njerëz që kishin ndikim në proceset që vazhdonin për luftën, kryeministri ka theksuar se edhe çmimi për ta nuk ishte i vogël, sepse të qëndroje përballë makinerisë luftare të Serbisë nuk ishte e thjeshtë.

Haradinaj ka thënë se brezi i UÇK-së e gëzon tani të drejtën ta ndërtojë lirinë dhe po e ndërton atë. "Është fat i madh që brezat e tjerë janë tani në obligim të një porosie, sakrifice, që ta ndërtojnë lirinë, ta ndërtojnë Kosovën", është shprehur

Haradinaj. Nga një fjalë rasti në këtë manifestim mbajtur edhe kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, Hysni Gucati, në emër të shoqatave të dala nga lufta dhe Muharrem Gashi, në emër të familjarëve të dëshmorëve. Pas manifestimit përkujtimor, kryeministri Haradinaj mori pjesë në zbulimin e pllakës përkujtimore, te kulla e ish-komandantit të UÇK-së Lahi Brahimaj, pasi kjo kullë, por edhe kulla të tjera, kanë qenë celula të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Fuqizimi i Agjencisë së Metrologjisë, i rëndësishëm për përmirësimin e jetës së qytetarëve

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka thënë se fuqizimi i mëtutjeshëm i metrologjisë së Kosovës është shumë i rëndësishëm për përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe për t'i përmbushur kriteret e parapara për MSA-në dhe ERA-n



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 17 MAJ - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, në Ditën Botërore të Metrologjisë ka thënë se mbrojtja e konsumatorit gjatë këtij mandati qeverisës ka qenë në fokus kryesor të MTI-së. Sipas Shalës, fuqizimi i mëtutjeshëm i metrologjisë së Kosovës është shumë i rëndësishëm për përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe për t'i përmbushur kriteret e parapara për MSA-në dhe ERA-n e, para së gjithash, të rritet standardi i jetës së qytetarëve tanë. "Ne tashmë kemi miratuar ligjin e ri të metrologjisë dhe jemi në proces të hartimit të akteve nënligjore në mënyrë që të implementojmë këtë ligj të standardeve të BE-së sa më mirë që është e mundur. Për më tepër, me ndihmën e Bankës Botërore jemi duke rehabilituar një objekt

të MTI-së që deri tash ka qenë i pashfrytëzuar dhe besojmë se gjatë vitit të ardhshëm do të krijohet edhe kushtet fizike dhe teknike që secili kriter ligjor i paraparë të jetësohet në atë që ne po e quajmë Qendra Kombëtare e Cilësisë së Kosovës", ka thënë Shala. Ai ka bërë me dije se gjatë fundvitit të kaluar dhe gjatë këtij viti MTI-ja ka nisur inspektimet e paparalajmëruara për matjen e peshës së bukës, me qëllim kryesor moslejimin e mashtrimit të qytetarëve. "Gjithashtu, gjatë fundvitit të kaluar kemi filluar edhe atë që po e quajmë Litritë, që nënkupton kalibrimin e pajisjeve të karburanteve duke evituar çdo mashtrim në këtë lëmë. Së shpejti do ta fillojmë edhe kontrollin e pajisjeve të tensionit të ulët, arit, orëve të rrymës dhe të ujit dhe, po ashtu, kalibrimin dhe kontrollin e pajisjeve mjekësore sepse tash-

më nuk do të lejojmë asnjë mashtrim për konsumatorin", ka thënë ai. Ministri Shala ka pohuar se me qëllim që Kosova të jetë një vend i suksesshëm në zhvillimin dhe përkrahjen e bizneseve të cilat do të mund të jenë konkurrenë në tregun e brendshëm dhe të

jashtëm, ka nevojë që të ketë një sistem metrologjie, të njohur në nivel ndërkombëtar. "Në bazë të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit, Kosova do t'i marrë masat e nevojshme në mënyrë që gradualisht ta arrijë përputhshmërinë me legjislacionin horizontal dhe sektorial të BE-së

për sigurinë e produktit dhe ta sjellë infrastrukturën e cilësisë, siç janë procedurat evropiane të standardizimit, metrologjisë, akreditimit dhe vlerësimit të konformitetit. Tashmë ligjet tona të standardeve të BE-së do të implementohen", ka deklaruar Shala.

Ministri Matoshi dhe ambasadori austriak koordinohen për bashkëpunim në fushën e mjedisit



PRISHTINË, 17 MAJ (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka pritur të premtën në takim ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Gernot Pfandler, me të cilin kanë biseduar mbi bashkëpunimin mes dy shteteve në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor. Ministri Matoshi, pasi ka falënderuar ambasadorin austriak për përkrahjen që shteti austriak po i jep shtetit të Kosovës në vazhdimësi, ka

prezantuar prioritetet, angazhimet dhe sfidat me të cilat po ballafaqohet shteti ynë në fushën e mjedisit. Matoshi ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellët në shkëmbimin e njohurive dhe mënyrave të trajtimit të shumë sfidave që kemi para vetes. "Kërkova nga ambasadori austriak përfshirjen më të madhe të shtetit të Austrisë në projekte të ndryshme në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor qoftë përmes bashkëpunimit me

MMPH-në, qoftë përmes projekteve me shoqërinë civile", ka thënë ministri Matoshi. Matoshi e Pfandler diskutuan edhe për përkrahjen që shteti austriak po i jep Pyllit të Arinjve në Prishtinë dhe për trajtimin e duhur të arinjve në vendin tonë. Ambasadori Pfandler shprehu gatishmërinë e tij dhe të shtetit që përfaqëson që ta rrisë bashkëpunimin me Ministrinë e Mjedisit për tejkalimin e sfidave që kemi para nesh.

"Eurowings" do ta shtrijë operimin në Kosovë

Prishtinë, 17 maj - Ministri i Infrastruktursë dhe Transportit, Pal Lekaj, ka pritur në takim të premtën drejtorin e Autoritetit të Aviacionit Civil, Eset Berisha, nga i cili ka marrë lajmin se kompania e njohur "Eurowings", pjesë e familjes Lufthansa, nga qershori do të shtrijë operimin e saj në Kosovë. Fillimisht, duke filluar me stacionimin e aeroplanit të

parë në ANP "Adem Jashari", për të vazhduar më pas edhe me hapjen e qendrës trajnuese dhe punësimit të vendësve. "Krahas kësaj, drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil, Eset Berisha, më informoi edhe për zhvillimet dhe të arriturat e tjera të institucionit që ai drejton. Në veçanti diskutuam për veprimet e ndërmarra për rritjen e sigurisë, ndryshimet që

pritet t'i bëhen Ligjit për Aviacionin Civil, mbrojtjen e të drejtave të pasagjerëve dhe përgatitjet drejt marrjes në kontroll të hapësirës së ulët ajrore. Ritheksua edhe një herë zotimin tim për ta siguruar trajtim meritore për personelin e aviacionit brenda administratës së shtetit", ka thënë Lekaj pas takimit.



Promovohet guida turistike për Kosovën në holandisht

Është promovuar në Hagë guida e parë për Kosovën në gjuhën holandeze, një libër që jep një përmbledhje të gjërave më të mira për ta vizituar vendin tonë. Libri i shkruar nga Gerda Mulder është botuar nga kompania numër një në Holandë për guida turistike përderisa ngjarjen e promovimit e ka organizuar Ambasada e Kosovës në Hagë

**EPOKA
ERE**

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 MAJ - Ambasada e Republikës së Kosovës në Hagë ka organizuar një ceremoni ku është promovuar libri i parë turistik për Kosovën në gjuhën holandeze i autores Gerda Mulder. Libri përmban informata të shumta rreth potencialit turistik të Kosovës. Në këtë ceremoni kanë marrë pjesë përfaqësues të shumtë të kompanive turistike holandeze dhe ekspertë të turizmit. I ftuar i veçantë ishte edhe Dan Everts, ish-shef i misionit të OSBE-së në Kosovë gjatë viteve 1999-2000.

Në hapje të ceremonisë, ambasadori i Republikës së Kosovës, Lirim Greiçevci, foli për mundësitë e jashtëzakonshme që ofron vendi ynë në fushën e turizmit si dhe për përparimin

që ka bërë Kosova gjatë 20 vjetëve të pasluftës. Ai falënderoi autoren e librit, Gerda Mulder, për kontributin e saj për promovimin e Kosovës. Ambasadori Greiçevci u bëri thirrje qytetarëve holandezë që ta vizitojnë Kosovën.

Në prezantimin e saj, autorja e librit Mulder foli për vende të ndryshme turistike, kulturën dhe mundësitë e shumta që ofron Kosova. Ajo u bëri thirrje bashkëvendësve të saj holandezë që ta vizitojnë Kosovën, duke u garantuar se do të mahnitën me atë që do të gjejnë.

Një fjalë rasti e mori edhe Dan Everts, i cili vlerësoi lart zhvillimin e Kosovës. Everts është shprehur i mahnitur me përvojën e tij sa ka qenë në Kosovë. Sipas Everts, Kosova, në veçanti malet

e Sharrit, janë vendi që duhet vizituar para se të vdesë njeriu. Ai ka thënë se është e jashtëzakonshme për të që njëzet vjet pas luftës të jetë pjesë e një organizimi në Ambasadën e Kosovës në Hagë për ta promovuar turizmin e Kosovës.

Në kuadër të kësaj ngjarjeje foli edhe Virtyt Gacaferri, organizator i vizitave turistike në Kosovë. Ai paraqiti disa mundësi dhe për-

parësi që ofron vendi ynë në fushën e turizmit. "Përkundër mangësive në menaxhimin e mbeturinave, në Kosovë mund ta gjeni natyrën më të paprekur në Evropë. Në bjeshkët tona nuk ka bujqësi të industrializuar, bari nuk prehet dhe bimët kanë jetë të plotë", ka shpjeguar Gacaferri mes të tjerash.

Në këtë ceremoni Ambasada në Hagë ka ofruar për pjesëmarrësit

verëra nga prodhues të Kosovës "Theranda Wine", "Kosova Wine", "Stone Castle" dhe "Bodrumi i Vjetër". Në Kosovë numri i turistëve holandezë është shumë i vogël përderisa ky libër mund ta ndihmojë rritjen e tyre. Në vitin 2018, sipas Zyrës së Statistikave të Kosovës, vendin e kanë vizituar 3 100 vizitorë nga Holanda, kurse 17 000 nga Gjermania.

Mbahet takimi i nënkomitetit të MSA-së për bujqësi, zhvillim rural, peshkatari dhe siguri ushqimore



BRUKSEL, 17 MAJ (ER) - Delegacioni nga Ministria e Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, i udhëhequr nga sekretari i përgjithshëm Kapllan Halimi, ka qëndruar në Bruksel për dy ditë në kuadër të takimit të tretë të nënkomitetit për "Bujqësi, zhvil-

lim rural, peshkatari dhe siguri ushqimore", i cili është realizuar ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Kosovës. Qëllimi i këtij takimi ishte vlerësimi i zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit - SAA, e cila

ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2016, si dhe realizimi i rekomandimeve të Raportit të Komisionit Evropian për nënkomitetin. Ministria e Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural ishte pjesë aktive raportuese e këtij nënkomiteti, ku të pranishëm

ishin përfaqësues nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë si dhe Ministria e Integritimit Evropian. Gjatë takimit përfaqësuesit e MBPZHR-së raportuan progresin e arritur gjatë vitit 2018 për zhvillimin e sektorit bujqësor si dhe për sfidat e së ardhmes, duke u

përqendruar veçanërisht në masat e ndërmarra për përmirësimin e situatës së tregut të produkteve bujqësore, fermat organike, standardet e tregut, politikat e cilësisë dhe legjislacionit, peshkimin dhe nënproduktet e tij etj.

Komuna e Malishevës fillon përgatitjet për organizimin e zgjedhjeve në fshatra

MALISHEVË, 17 MAJ (ER) - Komisioni komunal për organizimin e zgjedhjeve në fshatra dhe vendbanimet e Komunës së Malishevës ka mbajtur të premtën takimin e parë të punës. Në këtë takim është bërë zgjedhja e kryetarit të këtij komisioni si dhe janë ndarë grupet e

punës, ndërsa data e mbajtjes së zgjedhjeve do të përcaktohet pas një takimi të komisionit me kryetarët aktualë të fshatrave. Kryetar i këtij komisioni është zgjedhur kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës, Rrahim Morina. Në këtë takim të komisionit është diskutuar për

organizimin e zgjedhjeve dhe komisioni ka vendosur që paraprakisht të mbahet një takim me kryetarët aktualë të fshatrave, më pas të përcaktohet data e fillimit të mbajtjes së zgjedhjeve në të gjitha fshatrat dhe vendbanimet e Komunës së Malishevës.



Mjekët e QKMF-së në Prizren kanë kontrolluar 7 000 nxënës prizrenas

PRIZREN, 17 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka thënë se kanë përfunduar me sukses vizitat sistematike mjekësore në shkollat e kësaj komune. Ai ka bërë me dije se mjekët e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare

(QKMF) kanë realizuar vizita mjekësore në 56 shkolla të Prizrenit. "Falënderoj përzemërisht mjekët dhe personelin përgjegjës për përfundimin e suksesshëm të vizitave sistematike shëndetësore nëpër shkolla. Për një muaj e gjysmë

mjekët e QKMF-së janë angazhuar maksimalisht duke kryer vizita në 56 shkolla dhe kontrolluar mbi 7 000 nxënës, ku janë bërë 35 matje shëndetësore për ta kontrolluar zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve", ka deklaruar Haskuka.

Festa e Abetares këtë vit u festua me moton 'Ne festojmë të bashkuar'

PRIZREN, 17 MAJ (ER) - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ka organizuar të premtën manifestimin tradicional Festa e Abetares, me moton "Ne festojmë të bashkuar", e cila është mbajtur në Sallën e Sporteve "Sezai Surroi" në Prizren. Në këtë manifestim të pranishmëve u janë drejtuar me fjalë rasti ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi dhe

ministrja e Arsimit, e Sporteve dhe e Rinisë, Besa Shahini.

Ministri Bytyqi, pasi i uroi nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit për këtë festë të rëndësishme, e cila shënon hapin e parë të fatosave drejt dijes, tha se ndihet i lumtur që në këtë ditë festojnë bashkë nxënësit nga të gjitha trojet shqiptare, brezi i cili do ta ndërtojë të ardhmen e përbashkët.



Bizneset në Ferizaj pajtohen që e diela dhe festat zyrtare të jenë ditë pushimi



FERIZAJ, 17 MAJ (ER) - Dhjetëra përfaqësues të bizneseve, asamblistë të Kuvendit Komunal të Ferizajt dhe qytetarë ferizajas, kanë diskutuar në një dëgjim publik për Draftregulloren komunale për përcaktimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive të tjera në territorin e kësaj komune.

Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Ferizajt, Kristina Gashi-Bytyçi, ka thënë se kjo rregullore

është një dëshmi se qeverisja lokale e udhëhequr nga kryetari Agim Aliu është e përkushtuar për krijimin e kushteve të nevojshme dhe mbështetjen për bizneset dhe punëtorët e angazhuar në këto biznese.

Ndërsa drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Zekir Bytyqi, ka thënë se kjo rregullore është në dobi të bizneseve dhe të drejtave të punëtorëve, referuar edhe kërkesës nga një numër i konsiderueshëm i bizneseve fer-

izajas që patën parashtruar që dita e diel të jetë ditë pushimi për bizneset.

Ndërkaq përfaqësuesit e bizneseve në diskutimet e tyre e kanë mbështetur këtë rregullore për të vendosur rregull në orarin e punës së veprimtarive afariste dhe të tjera në territorin e Ferizajt. Përveç të dielës që të gjithë janë pajtuar që duhet të jetë ditë pushimi, ata kanë pasur edhe sugjerime sa i përket punës në ditët e festave zyrtare.

Organizata zvicerane AQH ndihmon shëndetësinë në Mitrovicë

MITROVICË, 17 MAJ (ER) - Organizata zvicerane që merret me sektorin e shëndetësisë AQH ka dhuruar një donacion në mjete pune për shëndetësinë në Komunën e Mitrovicës, pako në mjete për dhjetë qendra të mjekësisë familjare dhe dy pako për qendrën kryesore të mjekësisë familjare në Mitrovicë. Sipas kryeshefit të QKMF-së në Mitrovicë, Burim Pllana, këto pako në mjete pune

përbëjnë otoskop, oftalmoskop, pulsoksimetra, peshore, reflektor, inhalator, çanta për punë në terren dhe mjete të tjera pune që janë të nevojshme për punë të përditshme në qendrat mjekësore. Me këtë rast, kryeshefi i QKMF-së e ka falënderuar AQH-në, e cila në vazhdimësi e ka ndihmuar QKMF-në e Mitrovicës. Për këtë donacion, organizatën AQH e ka falënderuar edhe drej-

toresha e Drejtorisë për Shëndetësi, Erseka Hasanaj Barani. "AQH në vazhdimësi e ka përkrahur shëndetësinë në Mitrovicë me mjete pune dhe me trajnime dhe për këtë, në emër të drejtorisë, i falënderoj AQH-në, pasi këto mjete pune ndihmojnë në masë të madhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve", ka thënë Barani.



Lëreni presidentin Hashim Thaçi t'i realizojë të drejtat e shqiptarëve të Kosovës Lindore sepse ka të drejtë (2)



Spiro BUTKA

Me këto përpjekje luftarake Evropa shkundi botën pa lëvizur vetë aspak nga vendi. Beogradi i trembej Kosovës, por ajo vazhonte gjumin letargjik të imponuar nga Gandisti, si agjenti i dyfishtë, i UDB-së dhe shërbimit sekret të Francës. Edhe pse buzëqeshja e tij, në takimet me Millosheviqin vrasës, ratifikoi qenien si shërbëtor i më i zellshëm i Beogradit, veprimtaria subversive e tij, në dëm të çështjes kombëtare shqiptare, u mbars në vitet '90-ta, në qendër të Parisit, në një tavolinë të veçantë, me praninë e bashkëshortes të presidentit Francës të asaj kohe, në mesin e një nate të mynxyrët. Federata Jugosllave e sajuar, me qëllime të caktuara nga Kremli dhe "Eifeli", pas një gjakderdhje masive të boshnjakëve myslimanë, u shpërbë në kufijtë e mëparshëm, para traktatit famëkeq të Londrës, por me uzurpime të padrejta pas këtij traktati. Evropa sikur u shtrëngua dhe gati sa nuk u përplas brenda vetes, por Dejtoni përtej Atlantikut ndarës në mendim dhe veprim, mori vendimet përkatëse, në interes të situatave të reja dhe nuk la kohë për zvarritje të mëtejshme.

Kosova, brenda saj edhe ajo Lindore, mbetën të ngjitura me pashallëkun e Beogradit, i cili, çuditërisht, nuk iu nënshtrua një "Nurembergu" të kohëve të reja, për të dhënë llogari deri në një për viktimat e shkakutara, që edhe sot e kësaj dite kërkojnë drejtësi dhe vetëm drejtësi. Përfaqësuesi amerikan në Dejtonin përcaktues të fateve të popujve, pas atyre gjakderdhjeve brenda bashkësisë sllave, i pyeturi nga gazetarët për Kosovën, u përgjigj me të drejtë se "Kosova nuk ishte faktor". Një deklaram i hidhur, por brenda një realiteti të vërtetë. Nëse Kosova do ta kishte nisur luftën në kohën kur Beogradi përballlej me tri fronte, hapja e frontit të katërt nga Kosova për Serbinë do të ishte vdekjeprurës. Atë e sabotoi Gandisti, që sot e kësaj dite dyfytërisht e politikës pacifiste vazhdojnë t'i bëjnë nderime vazhdisë së turpshme brenda paradokseve shqiptare me njerëz të paturpshëm. Dejtoni u

mundua t'i mbyllte plagët e hapura nga përplasjet luftarake brenda gjinisë sllave, por luftërat nuk u ndalen. Ato mbarsën njëra-tjetrën. Në fillim Kosova dhe pa u tharë akoma gjaku i 2000 e ca dëshmorëve të saj, krisi pushka në Luginën e Preshevës. Luftërat kur nuk finalizojnë aktin final të Helsinkit, mbarsin njëra-tjetrën dhe nuk sjellin paqe, por vetëm luftë. Kështu, pas gjakut të derdhur në Luginën strategjike të Preshevës shqiptare, lufta polli luftën e shqiptarëve të Shqipërisë Lindore (të vetëquajturës Maqedoni), të uzurpuar padrejtësisht nga sllavët e vetëquajtur bullgarofolës.

Kosova u mbështet fuqimisht nga bota në luftë, kryesisht nga ShBA-ja, si lidheri kryesor i kësaj nisme luftarake, për shpëtimin e jetëve njerëzore nga krimet, masakrat dhe gjenocidi masiv i tërbuar serb. Luftën e humbi Serbia, por fituesi nuk u ftua në Kumanovë për tA firmosur traktatin, krahas aleatëve të luftës që, çuditërisht, lanë si në harresë legjendën e famshme të kombit shqiptar, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës Shqiptare.

Hapi që hodhën ndërkombëtarët në Kumanovë, për të mos njohur UÇK-në, i sqaroi shqiptarët për pasojat e mëvonshme. Folën dhe propajë flasin, duke propaganduar, për ndihmën që i është dhënë Kosovës në luftë e pasluftës, por nuk harrojnë të qajnë me lotët si lumë, për vrasarët më kriminelë në botë, nacionalistët e tërbuar hitlerianë serbë. Kosova u shpall shtet i pavarur, por Serbia dhe serbët vazhdojnë luftën e padukshme në Kosovë. Jo vetëm në Mitrovicën Veriore, por kudo ku janë ngulur, duke uzurpuar tokat e shqiptarëve, që i kanë syrgjynosur nëpër botë.

OKB-ja vazhdon të këmbëngulë, për kthimin e serbëve në Kosovë, por harron se ata që duhen kthyer patjetër në trojet e veta janë me miliona shqiptarë, të larguar me dhunë nga vendi i tyre.

Ushtria dhe policia serbe u larguan nga Kosova, por një pjesë e Kosovës, kryesisht ajo Lindore, ngeli peng i regjimit kolonial të Beogradit. I njëjti fenomen ndodhi dhe për trojet e Shqipërisë Lindore, që mbahen të pushtuara nga sllavët bullgarofolës. Në Londër, kur u nënshkrua traktati famëkeq, nuk kish Maqedoni dhe për më tepër, Kosova nuk ishte e ndarë në dy pjesë, pjesën lindore të së cilës e mban padrejtësisht të pushtuar Serbia. A është i drejtë një veprim i tillë? Dhe përse nuk mbahet qëndrimi i duhur? Përse

nuk kërkohet ndjesë për padrejtësitë historike që u janë bërë e po u bëhen shqiptarëve? Përgjigjja duhet dhënë, në përputhje me aktin final të Helsinkit, për të drejtat e njeriut dhe Kartën e Kombeve të Bashkuara të Sanfranciskos, për të drejtat e popujve e të kombeve. Kjo është dhe duhet të jetë drejtësia botërore, e cila më shumë përflitet e përgojet sesa zbatohet në interes të kësaj shoqërie njerëzore.

Serbisë po i hapen gradualisht dyert për t'u futur në Evropë nga serbofilët e Lindjes e Perëndimit, të shitur e të blerë në tregun politik evropian dhe atë botëror. Jo vetëm që nuk i plotëson kërkesat për t'u bërë pjesë e Evropës së bashkuar por, për më tepër, ajo nuk ka bërë asnjë ndryshim nga e kaluara e saj e errët nacionaliste, veçse tani e gjendur përballë realitetit të krimit të organizuar shtetëror, po mundohet me të gjitha mënyrat dhe mjetet për ta fshehur e mbuluar atë. Emisarët e saj për këto punë janë të shumtë, por më të avancuarit ishin dhe mbetën shërbëtorët e saj më të devotshëm, Karla del Ponte dhe Dik Marti, të cilët Beogradi i peshoi me flori, për ta vënë shenjën e barazisë midis vrasësit dhe viktimës. Evropa si e përgjumur i dëgjoj akuzat monstruoze të këtyre sharlatanëve të veshur me pushtetin e mandatarit dhe, ashtu si në të shkuar, i arkivoi ato, duke u bërë ilustrime e zëvendësime brenda lojës së rëndomtë, të fjalëve e shprehjeve.

U bëhet jehonë ndryshimeve pseudodemokratike të Serbisë pas millosheviqiane, duke filluar që nga Kushtunica i djeshëm e deri tek ai i sotëm, Vuçiq, të cilët, edhe pse paraqiten si moderatorë, ruajnë me nostalgji qenien e tyre si paramilitarët më të besuar të kohës së shkuar kriminale. E vjetra zëvendësohet nga e reja, por kjo e fundit nuk heq dorë nga e shkuara e, për më tepër, kur kemi të bëjmë me nacionalizmin serb të kultivuar në shekuj. Dhe faktet janë kokëforta. Populli i Kosovës Lindore luftoi për të drejtat e veta legjitime, por marrëveshja e Konçulit sanksionoi më tej kolonizimin serb. Bota dhe Evropa brenda saj, duke luftuar me të gjitha format e mënyrat, bëjnë të pamundurën për të mbrojtur një pakicë të vogël serbe në Kosovë, e cila nuk është në tokat e veta, por në ato të shqiptarëve, të syrgjynosur me dhunë në dhe të huaj. Harrojnë apo bëjnë sikur, se në Kosovën Lindore jetojnë shqiptarë në trojet e veta, gati sa njëqindfishi i ser-



bëve në Kosovë, e ata keqtrajtohen, arrestohen, burgosen, torturohen dhe dënohen në kufijtë maksimalë, vetëm e vetëm sepse luftojnë për të drejtat e tyre njerëzore, të mbështetura në ligjshmërinë botërore. Rasti më i dukshëm dhe vulgar që tregon për marrëzimit e drejtësisë serbe është vendimi i marrë nga Gjykata Speciale Serbe në Beograd, i kryesuar nga Snezhana Garotiq Nikoliq, e cila, nisur nga motivet e njohura politike nacionaliste serbe, dënoi luftëtarët e UÇPMB-së, mbi një shekull burgim, në kundërshtim të plotë me parimet, kriteret dhe kërkesat e aktit final të Helsinkit dhe Kartës së Kombeve të OKB-së.

Popujt e mbarë botës panë dhe shohin për ditë e më tepër krimet, masakrat e gjenocidin masiv të Serbisë kundër njerëzimit shqiptar, në luftë e pasluftës. Politika dhe aktorët që e luajnë atë, duke u hequr si parimorë, ulërinë në emër të drejtësisë, por kur vjen puna për t'i treguar vendin krimit të organizuar shtetëror serb, e anashkalojnë atë dhe, për më keq të asaj drejtësie që propagandojnë, akuzojnë shqiptarët viktimë, duke e barazuar pafajësinë e tyre me aktet makabre të krimit të organizuar shtetëror të Beogradit të tërbuar nacionalist. Kërkojnë gjilpërën në kashtë dhe nuk lënë gur pa lëvizur, për të akuzuar e paditur shqiptarët, në forume e organizma ndërkombëtare, përballë paudhësive dhe akteve mëkatore shekullore e të tashme, të serbëve vrasës e kriminelë.

U bë kohë që zhvillohen takime të përfaqësuesve shtetërorë të Prishtinës e Beogradit, ku agenda e deritanishme ka ngjallur diskutime për ardhmërinë e Kosovës dhe njohjen zyrtare të saj nga ana e qeverisë serbe. Kosova nuk është ajo e kufijve të uzurpuar arbitrarisht nga Serbia, por pjesë e saj është edhe ajo Lindore, në kufijtë etnikë e realë, të pushtuar ushtarakisht me dhunë nga

Mbretëria Serbe pas vitit 1913. Përballja në diskutime paraqet vështirësitë e kohës, por kjo e fundit kërkon zgjidhjen e duhur dhe optimale të çështjes kombëtare shqiptare, e cila bazohet në parimin e së drejtës për vetëvendosje, për cilindo popull e komb, anëtar i OKB-së e pjesëtar i Evropës së bashkuar. Shqiptarët e Kosovës Lindore e kanë thënë fjalën e tyre në referendumin përkatës popullor të kryer në Luginën e Preshevës vite më parë. Zhvillimi i tij u mbështet në kërkesat e Kartës së Kombeve të OKB-së për të drejtat e popujve e kombeve dhe në aktin final të Helsinkit për të drejtat e njeriut. Nëse Serbia do që të jetë pjesë e kësaj bote demokratike, le ta bindë opinionin publik ndërkombëtar se ajo, në ndërtim të së ardhmes të popullit të vet, jo vetëm se nuk do të jetojë më me të shkuarën, por do ta braktisë atë, duke u distancuar nga e kaluara e saj e errët. Por a ekziston një vullnet i tillë? Le të shpresohet edhe një herë, për herë të fundit nga ajo. Ja pra pse ka të drejtë presidenti Hashim Thaçi. Prandaj lëreni të punojë i qetë, për realizimin e aspiratave shekullore të shqiptarëve autoktonë të Kosovës Lindore. Ai dha prova të mëdha dje në luftë, duke rrezikuar jetën e tij në moshë të re. E vazhdoi atë dhe në Rambuje. Pas luftës është po ai që luftoi dhe e konkretizoi atë me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Kështu po vepron edhe në rastin konkret. Ai nuk është vetëm, sepse edhe në Konferencën e Rambujes po ashtu dihet me cilin ishte e bashkëpunoi. Intervista e tij në "TV Klan" qartësoi shqiptarët e kudondodhur. Kush ka sy në ballë e mendje të kthjellët, e kupton dhe e mbështet. Ish-luftëtarët e UÇK-së janë dhe do të mbeten besnikë të tij. /Fund/

(Autori është ish-drejtues në Sh.O operacionin "Shigjeta" në luftën e UÇK-së. Aktualisht kryetar i ShVL të UÇK-së, Tiranë)

Mbahet tryeza "Ukshin Hoti - Dritë; Dritë - Ukshin Hotit!"

Kërkohet nga institucionet e Kosovës dhe mekanizmat ndërkombëtarë informata për fatin e Ukshin Hotit dhe personave të zhdukur

Shoqata e ish të Burgosurve Politikë të Kosovës, Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve, Instituti Albanologjik - Prishtinë dhe Shoqëria "Lëvizja" kanë lëshuar një deklaratë të përbashkët për rastin e zhdukjes së dhunshme të Ukshin Hotit nga autoritetet shtetërore të Serbisë

PRISHTINË, 17 MAJ (ER) - Më 16 maj u organizua tryezë me titull "Ukshin Hoti - Dritë; Dritë - Ukshin Hotit!" për Ukshin Hotin në 20-vjetorin e rrëmbimit të tij të dhunshëm. Tryeza u organizua nga Shoqata e ish të Burgosurve Politikë të Kosovës, Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve, Instituti Albanologjik - Prishtinë dhe Shoqëria "Lëvizja". Enkas për këtë aktivitet u ftuan dhe mbajtën fjalën e tyre Hysen Matoshi, Moikom Zeqo, Bislim Elshani, Sabri Kijçmari, Afërdita Dervishi, Bislim Zogaj, Krenar Zejno.

Hydajet Hyseni, drejtues i tryezës, në fund të diskutimeve ka propozuar deklaratën e përbashkët për rastin e zhdukjes së dhunshme të Ukshin Hotit nga autoritetet shtetërore të Serbisë:

Duke pasur parasysh Kartën e

Duke rikujtuar Deklaratën për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja e Dhunshme, të Asamblesë së Përgjithshme të OKB, miratuar me Rezolutën A/RES/47173, 20 dhjetor 1978 dhe A/RES/47/133, 18 dhjetor 1992 të plotësuar e ndryshuar më 14.02.2008;

Të ndërgjegjshëm për dhembjen dhe traumën e jashtëzakonshme që shkakton zhdukja e dhunshme, e cila përbën krim të rëndë, që në rrethana të caktuara në të drejtën ndërkombëtare definohej edhe si krim kundër njerëzimit;

Duke pasur parasysh të drejtën e çdo personi që të mos jetë subjekt i zhdukjes së dhunshme, si dhe të drejtën e viktimave për drejtësi dhe dëmshpërblim;

Duke njohur të drejtën e viktimave për të ditur të vërtetën për rrethanat



në vendbanimin e vet, te familja e vet, dhe nuk u pa nga asnjë person tjetër që do të mund të dëshmonte se ai ishte liruar i gjallë; Duke u nisur nga fakti se në Kosovë, tani e 20 vjet, edhe mbi 1560 persona të tjerë akoma mbeten të zhdukur, të gjithë të arrestuar, ndaluar, rrembyer me forcë nga persona të autorizuar apo të afiluar dhe me miratimin e autoriteteve shtetërore të Serbisë.

Pjesëmarrësit e Tryezës "Ukshin Hoti Dritë, Dritë për Ukshin Hotin!"

Duke rikujtuar detyrimin e palëve nënshkruese të ICPPED, edhe të Serbisë, e cila është palë që ka ratifikuar Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja e Dhunshme, më 18 maj 2011, për të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për të sanksionuar veprimet si: Dështimin për të regjistruar privimin nga liria të çdo personi, apo regjistrimin e çfarëdo informate për të cilën personat zyrtarë përgjegjës për mbajtjen e regjistrat zyrtar janë apo do të duhej të ishin në dijeni, madje edhe kur këto informata janë jokorrekte; refuzimin për ofrimin e informatave për privimin e lirisë të çdo personi, apo ofrimin e informatave jokorrekte

te, madje edhe nëse dh janë përmbytur kërkesat ligjore për sigurimin e një informacioni të tillë; vonesat apo pengesat në ofrimin e mjeteve juridike (Neni 22, ICPPED).

Po ashtu, duke rikujtuar detyrimin e shteteve palë të ICPPED për të garantuar se çdo person ka të drejtë të di të vërtetën në lidhje me rrethanat e zhdukjes së dhunshme, për rrjedhën dhe rezultatet e hetimeve si dhe fatin e personit të zhdukur; detyrimin për të ndërmarrë të gjitha masat e përshtatshme për kërkimin, gjetjen dhe lirimin e personave të zhdukur, si dhe në rast vdekjeje të trajtojë me respekt dhe kthimin e mbetjeve mortore; detyrimin për të siguruar nëpërmjet sistemit të vet ligjor që viktimat e zhdukjes së dhunshme të marrin dëmshpërblim dhe kompensim të shpejtë, të drejtë dhe adekuat për dëmin material e moral, e në rastet e rënda edhe kthimit, rehabilitimit, satisfaksionit, përfshirë edhe rivendosjen e dinjitetit dhe të reputacionit dhe garancitë për të mos përsëritur veprën (Neni 24, ICPPED).

Kërkojnë nga institucionet kompetente shtetërore të Republikës së Kosovës, që të kompletojnë dosjen për rastin Ukshin Hotit, për rastet e shumë personaliteteve të shquara politike, intelektuale, arsimore, artistike e shoqërore dhe mijëra qytetarëve të pafajshëm dhe të pambrojtur,

të moshuar, të rinj, gra e fëmijë, të zhdukur dhunshëm, të vrarë e masakruar, të varrosur, të zhvarrosur e të transportuar kolektivisht nga Kosova në vende të panjohura në Serbi, me qëllim të fshehjes së gjurmëve dhe dëshmimeve për abuzimin kriminal, çnjerëzor dhe trupat dhe organet e pengjeve të zhdukur.

Përfaqësuesit institucional të Republikës së Kosovës, të kërkojnë nga institucionet kompetente ndërkombëtare që të shfrytëzojnë dhe ushtrojnë ndikimin e tyre tek autoritetet e Serbisë, për të zbardhur të vërtetën për zhdukjet e dhunshme, për të pranuar përgjegjësinë individuale dhe shtetërore dhe përballjen me drejtësinë të aktorëve, urdhërdhënësve dhe përgjegjësve, të përfshirë në krimet masive, dhe ta adresojnë në mekanizmat përkatës ndërkombëtarë.

Pjesëmarrësit e tryezës kërkojnë nga përfaqësuesit institucionalë të Kosovës që, zbardhjen e fatit të Ukshin Hotit, të veprimtarëve tjerë të shquar dhe mijëra të të pagjeturve, pranimin nga shteti serb të fajësisë dhe marrjen e përgjegjësisë për krimet, dëmet dhe pasojat e shkaktuara, të trajtojnë si një nga parakushtet e domosdoshme për një proces të mirëfilltë normalizimit e marrëdhënieve midis dy shteteve të lira, sovrane dhe të barabarta; Në mënyrë të veçantë, pjesëmarrësit e tryezës kërkojnë nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe mekanizmat ndërkombëtarë, informata të plota për fatin e Ukshin Hotit dhe personave të zhdukur nga Kosova gjatë luftës në Kosovë 1998-1999, për vendndodhjen e tyre, e në rast të vrasjes së tyre, varret e tyre, kthimin e mbetjeve mortore, masat e ndërmarrja për ndjekjen dhe dënimin e personave përgjegjës për këto krime, kompensimin dhe dëmshpërblimin e shpejtë, të drejtë dhe adekuat për dëmet materiale e morale, rehabilitimin e viktimave, kërkimfajlen shtetërore nga Serbia, rikthimin e dinjitetit e reputacionit të viktimave, familjeve të tyre dhe gjithë shoqërisë në Kosovë.



Kombeve të Bashkuara; Duke pasur parasysh Deklaratën Universale për të Njeriut; Duke rikujtuar Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të Drejtën Humanitare dhe të Drejtën Penale Ndërkombëtare;

Duke pasur parasysh Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja e Dhunshme (ICPPED), 20 dhjetor 2006, sipas së cilës "zhdukje e dhunshme" konsiderohet arrestimi, ndalimi, rrëmbimi apo çdo formë tjetër e privimit nga liria nga agjentet e shtetit apo nga persona a grupe personash që veprojnë me apo sipas autorizimeve shtetërore, me mbështetjen apo edhe miratimin e shtetit, duke e vendosur personin e zhdukur jashtë fushëveprimit dhe pa mbrojtje nga ligji.

e zhdukjes së dhunshme dhe fatin e personit të zhdukur, si dhe të drejtën për të qenë i lirë për të kërkuar, për të pranuar dhe për të dhënë informacione në lidhje me këtë;

Duke njohur të drejtën absolute të çdo njeriu që mos jetë apo bëhet subjekt i zhdukjes së dhunshme, dhe se, asnjë rrethanë e jashtëzakonshme, lufte apo të rrezikut të luftës, rrethanat të gjendjes politike jostabile apo çfarëdo rrethanë tjetër e jashtëzakonshme, nuk mund të jetë justifikim për zhdukjen e dhunshme;

Duke u nisur nga fakti se Ukshin Hoti, me datë 16 maj 1999, pas përfundimit të dënimit të padrejtë, dhe nxjerrjes nga burgu, nga gardianët zyrtarë të burgut të Dubravës, ditën e diel, ditë kjo jo e punës dhe e pazakonshme për lirim të të burgosurve, nga hapësira e burgut, jashtë mureve të jashtme të burgut, mirëpo duke qenë ende në perimetrin e kontrolluar nga autoritetet e burgut, kurrë nuk arriti



Roli i komunikimit ndërmjet Ismail Kadaresë dhe Ukshin Hotit

'Bisedë përmes hekurash'



Prof. asoc. dr. Shkelqim MILLAKU

Çdo bashkëbisedim midis dy njerëzve që nuk janë takuar kurrë, që ndodheshin tepër larg njëri-tjetrit e në kushte tejet të ndryshme është dhe ishte padyshim i vështirë. Shkrimin tim analizues dhe vështrues do ta rreshtojë në disa këndvështrime dhe në thelb të veçantë do të analizohet komunikimi ndërmjet I. Kadaresë dhe profesor Ukshin Hotit, kurse theksi do të bije mbi mendimet filozofike, politike dhe diplomatike të profesor Ukshin Hotit. Ai është vigan i kombit, arkitekt dhe ideator i konceptit të Republikave të Bashkuara Shqiptare.

Kontributi i profesor Hotit është shumëdimensional. Mendimet polisemike, të cilat ishin filozofike, politike, diplomatike dhe konceptet e tij mesazhdhënëse për lirin ishin objektive dhe të arsyeshme. Profesor Hoti ishte i mishëruar për zgjidhjen e problemit të çështjes shqiptare dhe në veçanti atë të shoqërisë së Kosovës. Konceptet e prof. Hotit bëhen më të kompletuar atëherë kur edhe i krahason dhe i përshkruan ato në shtrirjen gjeopolitike dhe gjeostrategjike si të Evropës, ShBA-vë dhe në veçanti shtohet pesha e mendimeve kur i kushton kujdes dhe vëmendje të veçantë ndaj shteteve dhe veprimeve sllave.

Njohja e së kaluarës historike e popullit tonë dhe shteteve në fjalë e kanë fuqizuar profesor Hotin të jetë lider i kuptimit të plotë të fjalës. Mendimet e tij do të mbetën udhërrëfyes për shtetndërtimin dhe shtetndërtimet tonë.

Ismail Kadare në librin "Bisedë përmes hekurash" citon: "Ndërkaq ju jeni padyshim i burgosuri politik numër Një i Evropës. Unë nuk di ndonjë rast tjetër kur në burgjet e këtij kontinentit të dergjet një personalitet i përmasave tuaja: profesor universiteti, politikan i njohur i ish-stabilizimit politik jugosllav i shquar në përpjekjet për demokratizimin e Jugosllavisë, ish-ministër i jashtëm i Krahinës Autonome të Kosovës, i shquar për orientimin pro-perëndimor e proantialik, publicist i njohur i specializuar në "Harvard" të ShBA-së për shkencat politike, autor librash të rëndësishme si "Filozofia politike e çështjes shqiptare", "Lufta e ftoftë dhe detanti".

Libri "Bisedë përmes hekurash" është menduar për t'i thyer heku-

rat dhe sigurisht se roli i librit është shumëdimensional, të cilat, po i veçojmë disa nga ato. Misioni i librit:


a. Rugën e mundshme për ta liruar liderin,
b. Publikimin e pikëpamjeve vizionare të Ukshin Hotit,
c. Informimin e opinionit publik kombëtar dhe ndërkombëtar për gjendjen faktike të shoqërisë. Këto dhe shumë pikëpamje të tjera e bëjnë librin dhe komunikimin e dy liderëve fuqplotë, komunikim sigurisht mjaft i vështirë për atë kohë për t'u realizuar, por edhe mjaft mesazhdhënëse.

Ismail Kadare e kishte vullnetin për të shërbyer dhe dëshmuar se kush ishte Ukshin Hoti, por edhe për rolin e tij filozofik, politik e diplomatik, rol i mundshëm për lirinë e vendit tonë. Njeriu i penës, Ismail Kadare kishte vendosur një qasje tjetër për të bërë përpjekje për lirinë e liderit. Ai me një shpresë shumë të kufizuar në kohë fillon për t'i dërguar disa pyetje në burg, në adresën dhe në emrin e Ukshin Hotit. "Secila pyetje e Kadaresë pjesërisht ngërthen edhe përgjigjen ..." (I. Kadare, f.123). Kjo rrugë e komunikimit edhe sot në rrethana krejtësisht tjerat shtetërore dhe politike do të shihet jo e lehtë për t'u realizuar për të mos e krahasuar gjendjen e asaj kohe kur Ukshin Hoti ishte i burgosur politik. Ideja ishte e drejtë dhe pyetjet filluan të arrinin në adresën e duhur. Mrekullia historike e ka filluar rrugën e vetë. Përgjigjet filluan të dalin. Profesor Ukshin Hoti e thotë edhe vetë se kohën e kishte shumë të shkurtër për t'u referuar dhe përgjigjur objektivisht, pra rreth dy apo tri orë i kishte të mundshme për letërkëmbim.

Pjesa e parë e librit përbëhet nga pyetjet e Kadaresë, të cilat krijuan mundësinë për një libër të tillë, i cili ka vlera të veçanta dhe do të mbetet kapitale.

Kadare duke i kuptuar rrethanat politike dhe të gjendjes faktike ishte i kujdesshëm në kërkesat dhe komentet e tij. Ai dinte çka kërkonte!

Çështja e parë, bashkëbisedimi ishte shumë i vështirë për t'u



shkëmbyer dhe publikuar, por vendosmëria dhe guximi i tyre e bërë të mundur një komunikim mjaft të rëndësishëm, sigurisht fal edhe guximit të atyre që i ndihmuan një procesit të tillë, i cili ishte mjaft i rrezikshëm për të burgosurin dhe për ata që mendonin ta dërgonin porosinë e Kadaresë.

Në gjitha drejtimet dhe rrethanat një lëvizje e tillë ishte e vështirë. Ukshin Hoti për një bisedë letërkëmbëse të tillë ishte i gëzuar, e kishte mirëpritur por edhe i habitur. Ai që në fillim falënderon shkrimtarin tonë të njohur Ismail Kadarenë, i cili qe ideator dhe udhërrëfyes për një komunikim të tillë. Kadare do t'i shpalos mendimet filozofike, politike, diplomatike dhe polisemike të Ukshin Hotit.

Ai që në fillim përshkruan jetëshkrimin e tij dhe të familjes së tij. Prindi i Ukshin Hotit e urrente fjalën politikë dhe si përmbytje të tillë, e kishte këshilluar që ta ndërronte fakultetin. Ai ia shpjegonte Ukshinit se për t'u marrë me politikë 'duhej futur kokën në strajcë'.

Ukshin Hoti ka përdorur disa fragmente mesazhdhënëse politike dhe me kuptim të plotë diplomatike për shtrirjen e mundshme gjeopolitike dhe gjeostrategjike të vendit tonë në rrugëtimin e ndërtimit të Republikave të Bashkuara Shqiptare.

Problemi qëndron të përmbytje e orientimit dhe jo në vetë orientimin, mendova se Evropa ose

Evro-Amerikën, së cilës Kadareja po ia shton edhe atë "atlantike". Hoti duke i njohur mirë konceptin e shoqërisë evropiane dhe të atyre amerikane, profesor e kishte idenë e thelluar dhe të menduar drejt dhe objektivisht për mundësinë e liritimit, por edhe të mbështetjes reale për lirinë.

Si shumë intelektual të tjerë, në fillim edhe profesor Hoti nuk ishte që çështja e shoqërisë së Kosovës të zgjidhej me luftë, përderisa ka rrugë diplomatike, prandaj kërkesat ishin të rregullohet gjendja përmes forcës politike dhe diplomatike, kryesisht duke e kërkuar dhe krahasuar mbështetjen politike të faktorit kombëtar dhe të atij ndërkombëtar, mirëpo më vonë rrethanat dhe koha e binden për ta ndryshuar mendjen se vendit i duhet ushtria për ta liruar vendin. Hoti ishte vizionar i thelluar, ai në përgjigjeje e më vonë në libër ka përdorur disa terme mjaft kuptimore dhe të mundshme për t'u realizuar, si: Gjermanizimi i Evropës apo Evropianizimi i Gjermanisë, ku Franca dhe Britania do të lozin ndonjë rol me rëndësi ...

Sintagmat Evro-Amerikë, Gjermanizimi i Evropës apo Evropianizimi i Gjermanisë dhe Republikat e Bashkuara Shqiptare në shikim të parë janë të lexueshme lehtë, por në fakt kanë përmbytje shumë të thelluar si nga ana e fuqive ekonomike, po ashtu edhe nga roli i tyre filozofik, politik e diplomatik.

Profesor Hoti gjatë dhënies së përgjigjeve siç thamë edhe më lart kohën e kishte të kufizuar dhe i mungonin materialet për t'i cituar dhe argumentuar kronologjinë e ngjarjeve, prandaj si i tillë mendimet e dhëna, ndonjëherë nuk e kanë edhe lidhshmërinë kronologjike të ngjarjeve, por kujdesshëm i rikthehet, i plotëson dhe nuk i mbetet borxh për t'i përmendur faktorët relevant të krijimit të situatës politike.

Prandaj, nuk është e rastit kur ka menduar për "Evro-Amerikë", sepse për ne është parë një shpresë e fuqishme për lirinë dhe jo për 'çlirim' siç e thotë edhe vetë Ukshin Hoti.

Fjalën "Evro" e specifikon sepse e sheh shpresën e zhvillimit ekonomik, diplomatik dhe të mbështetjes së fuqishme politike, pra Gjermanizimi i Evropës apo Evropianizimi i Gjermanisë kjo në kuadër të termit "Evro" dhe "Gjermanizim", por edhe të funksionit përmbytjesor të saj është padyshim shpirti socio-politik i saj dhe shpresa e liritimit dhe integritetit të shoqërisë shqiptare.

Profesor Ukshin Hotit nuk i ka ikur pa i përmendur vizionaret dhe liderët e kohës, si ata kombëtar po ashtu edhe ata ndërkombëtar, të cilat kanë luajtur një rol shumë të madh në rrugën e

liritimit apo ndoshta edhe të okupimit të vendit.

Fuqia e punës së organizatave studentore të UP-së që i vlerësuar lart nga Ukshin Hoti dhe dalja e UÇK-së në skenë, e cila hapi një guxim dhe rrugëtim plotësues për të dalë nga robëria shekullore.

Prof. Ukshin Hoti në librin "Bisedë përmes hekurash" prezanton pikëpamjet dhe vizionin e tij të shëndosh për ta liruar vendin dhe për ta ndërtuar shtetin dhe shtetet shqiptare. Fuqia e falës së tij është e fortë sepse ai i krahason mendimet e liderëve ndërkombëtar dhe kombëtar, por në veçanti i përshkruan dhe krahason fatin e popullit shqiptar me fatin popujve të Evropës e më gjerë. Fragmenti i fundit, i cili është krahasues, por edhe përvoja e së kaluarës të popujve për prof. Ukshin Hotin është një argument i fuqishëm i nivelit të lartë të tij intelektual dhe akademik.

Ai padyshim ka një guxim komunikues mjaft të drejtë dhe është një vizionar i thellë. Njohës i thellë dhe shumë i brengosur për fatin e popullit shqiptar si në Kosovë dhe në vendet e tjera ku shqiptarët nuk i gëzonin të drejtat e tyre.

Ai me shumë të drejtë dhe objektiv i ka menduar sintagmën polisemike Republikat e Bashkuara Shqiptare.

Profesor Ukshin Hoti është arkitekt shteti, vigan dhe strateg i kohës për sintagmën kuptimore dhe diplomatike në fjalë, i cili e ka propozuar fillimisht të rregullohet gjendja e Kosovës, të bëhet shtet Kosova, e pastaj të vazhdohet me të drejtat e shqiptarëve në vendet e tjera për liri. Kjo ide nuk ka rrugë të dytë, por ka vetëm një rrugë edhe sot ajo duhet të vazhdohet për të drejtat e qytetarëve shqiptar në vendet e ndryshme. Për të përfunduar shkrimin tim mund të themi se prof. Ukshin Hoti është njëri ndër intelektualët më meritore dhe arkitekti udhërrëfyes i pavarësisë së Republikës së Kosovës. Gjuha direkte dhe diplomatike e tij është polisemike, filozofike dhe padyshim se do t'i shërben brez pas brezi shoqërisë shqiptare në gjitha rrugëtimet jetësore.

Ai është njëri ndër udhërrëfyesit dhe arkitekti i shtetit modern shqiptar.

(Kumtesa është lexuar me rastin e njëzetvjetorit të zhdukjes së profesor Ukshin Hotit. Akademia është organizuar nën përkujdesjen e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj dhe kryetarit të Komunës së Rahovecit, z. Smajl Latifi dhe nga Universiteti "Ukshin Hoti" i Prizrenit.

Autori i shkrimit është profesor në Fakultetin e Filologjisë në Prizren).

Prizren, 16.05.2019



E jashtëzakonshme

Ngjitet 23 herë në Everest, 49-vjeçari nga Nepali vendos rekord të ri



Për miliarda persona në botë ngjitja e Everestit është një mision i rrezikshëm, i mrekullueshëm, por edhe i pamundur njëkohësisht. Por, kjo nuk vlen për Kami Rita Sherpa, për të cilin një aventurë e tillë rezultoi si diçka rutinë teksa ai

regjistroi rekordin e 23-të për sa i përket ngjitjes në majën më të lartë të botës. Sherpa, që tashmë është 49 vjeç, e përmbushi misionin e vet këtë të mërkurë duke thyer rekordin që ai kishte vendosur vetë vitin e kaluar.

FOTO E DITES



Çiklistët përplasen gjatë fazës së gjashtë të garës 102 "Giro d'Italia - Tour of Italy - cyle. /AFP/

E rrallë

Gëlltiti 116 gozhda dhe një kablo të gjatë, pas intervenimit kirurgjik burri nga India shpëton

Hekuri pa dyshim se është një nga elementet kyçe për funksionimin e shëndoshë të organizimit të njeriut, mirëpo një burrë nga India duket se e ka kuptuar paksa gabim këtë çështje. Ai për "drekë" kishte ngrënë 116 gozhda të çelikut, disa copëza të metalta dhe një kablo të gjatë gjithashtu të



çeliktë. Të gjitha këto mjekët janë detyruar t'i nxjerrin nga barku. Kirurgu nga Bundi, qytet ky në Rajastan, mbeti i habitur kur i bëri rëntgenografinë dhe pa se në barkun e pacientit kishte shumë mjete të metalta.

BARSOLETA E DITËS



Vjen gruaja në shtëpi, e nevrkosur.
- Zemër, do ta padis taksistin në gjykatë.
Sot, në dy raste, për pak sa nuk më vrau.
- Mos u ngut zemër. T'i japim edhe një rast.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

"DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton



Ne ora 16:00 dhe 19:00

"AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

"EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger



16.05.2019

"THE HUSTLE"

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Po mendoni ndryshime radikale në të ardhmen. Kjo nuk përfshin persona që ju kanë mbështetur këtë periudhë dhe që do të ndihen keq.</p>	 <p>DEMI Keni lejuar që personat pranë jush t'ju karikojnë me energji negative dhe kjo ditë nuk do të jetë aq e mirë dhe e gëzueshme sa zakonisht.</p>	 <p>BINJAKËT Nuk po gjeni vetveten në një ambient të ri dhe kjo gjë do të ndikojë të mbylleni dhe të mos komunikoni shumë me të tjerët.</p>	 <p>GAFORRJA Doni të jeni ju të parët në komunikime dhe zgjidhje të rëndësishme në ambientin e punës dhe për këtë arsye shumë herë ekzagjeroni.</p>	 <p>LUANI Ka gjithmonë të papritura në rrugën që përshkoni. Mos jini të sigurt për gjëra që nuk janë në dorën tuaj. Jepuni zgjidhje disa problemeve që do t'ju dalin.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Do t'ju duhet të shpjegojeni për disa situata që të të tjerët kanë lënë shije të keqe, sidomos tek ata që ju kanë më për zemër.</p>
 <p>PESHORJA Do të hasni në disa pengesa që do t'jua prishin humorin sot. Mund t'u flisni me një ton të ashpër personave që nuk e meritojnë.</p>	 <p>AKREPI Ajo që po ndodh rreth jush vjen si pasojë e veprimeve të njëpasnjëshme që keni marrë. Nëse nuk do t'ju pëlqejë duhet të shikoni opsione të reja.</p>	 <p>SHIGJETARI Nuk po arrini ta kuptoni sjelljen e disa personave karshi jush. Kjo ju ka futur në një pasiguri që po ju shqetëson disi sot.</p>	 <p>BRICJAPI Duhet t'i jepni më shumë kohë në dispozicion partnerit të shpjegojë një situatë që është keqkuptuar nga të dyja palët.</p>	 <p>UJORI Sot keni nevojë të çlirohni nga stresi i ditës dhe po kërkoni alternativa të reja për t'u kënaqur. Do të jeni në kërkim të një flirti të çastit.</p>	 <p>PESHQIT Nuk ka asgjë të keqe të kërkoni më tepër nga një marrëveshje apo edhe nga një flirt i ri. Por do t'ju ngatërrohen gjërat rrugës.</p>

A janë bashkë Lauren Alaina dhe John Crist?



Këngëtarja dhe tekstshkruesja amerikane Lauren Alaina para pak kohe është ndarë nga i fejuari Alex Hopkins. Alaina tani

është në lidhje të re të dashurisë me komedianin John Crist. Sipas "Hollywood Life", këngëtarja ka qenë e fejuar shtatë vjet me Hopkins.

Madonna publikon këngë të re



Madonna ka publikuar edhe një projekt të ri muzikor. Këngëtarja 60-vjeçare u bë bashkë me Quavo për këngën e re të titulluar "Future", e cila është e fundit e shkëputur nga albumi i saj i ardhshëm "Madame X", të cilin pritet ta publikojë më 14 qershor. Kujtojmë

se turneu i saj "The Madame X" është planifikuar të nisë më 12 shtator. Këngëtarja me famë botërore është konfirmuar se do të performojë të shtunën në Izrael në natën finale të "Eurovision"-it, në skenën e së cilës do të këndojë edhe përfaqësuesja e Shqipërisë, Jonida Maliqi.



Kim Kardashian nxjerr linjën e re të produkteve të grimit

Ylli televiziv Kim Kardashian të premten do ta lansojë linjën më të re të produkteve të grimit. Kardashian ka vendosur që këtë linjë të re të kozmetikës ta lansojë në përvjetorin e pestë të martesës së saj me reperin Kanye West. Këtë e ka bërë me dije vetë Kimi me anë të postimeve në



rrjetin social "Instagram", ku shihet se ajo është vetë pjesë e kësaj kampanje.

Reeves është krenar që është person me ngjyrë



Në një intervistë për "Essence", Keanu Reeves ka folur hapur për faktin që iu takon njerëzve me ngjyrë. Teksa shumica e fansave e njohin aktorin si yllin 54-vjeçar nga Kanada, ai

faktikisht ishte rritur i rrethuar me kulturë kineze dhe thotë se është krenar me trashëgiminë e tij. Keanu tha se ai, "megjithatë, nuk është përfaqësues" për aktorët aziatikë në Holliwoodit.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82

Feronikeli dhe Prishtina kërkojnë titullin

Skuadrës së Feronikelit, përveç fitores, i mjafton edhe barazimi në ndeshjen e fundit të kampionatit ndaj Prishtinës që të shpallet kampione e Superligës, kurse skuadrës "bardhekaltër" i duhet fitorja nëse dëshiron ta sjellë trofeun në kryeqytet. Përballja në mes këtyre dy klubeve zhvillohet të dielën në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 17 MAJ - Titulli i kampionit në IPKO Superligën e Kosovës në futboll për edicionin 2018/2019 do të vendoset nesër (e diele) në ndeshjen që zhvillohet në Drenas në mes të Feronikelit dhe Prishtinës. Të dyja skuadrat kanë pasur një ecuri fantastike në kampionat, duke dominuar gjatë gjithë kohës dhe aktualisht Feronikeli është në pozitën e parë me dy pikë më shumë se Prishtina. E vetmja skuadër që i rivalizoj deri në fund këto dy skuadra ishte Llapi i Tahir Batatinës, kurse Drita që është kampione në fuqi nuk tregoi aspak 'forcë' për ta mbrojtur titullin e fituar një vit më parë.

Futbollisti Përparim Islami ka thënë për gazetë se "jemi shumë afër titullit të kampionit. Assesi nuk bën të gabojmë në ndeshjen e fundit. Pozitiv për ne është fakti se kemi në opsion dy rezultatet: fitoren dhe barazimin. Ne futbollistët jemi të gatshëm të luajmë ashtu siç kemi bërë deri tash dhe ta përmbushim objektivin në kampionat duke e fituar trofeun", ka thënë Islami.

Ndërsa trajneri Zekrija Ramadani ka konfirmuar se skuadra e tij në këtë ndeshje

do të luajë futboll sulmues ashtu siç bëri gjatë gjithë kampionatit. Ndërsa sulmuesi i Prishtinës, Basid Khalid, për faqen e klubit ka thënë se ndeshja në Drenas do të jetë e vështirë, por se Prishtina do të luftojë shumë për fitore dhe në fund do të shpallet kampione. "Ndeshja e fundit do të jetë e vështirë, Feronikeli është ekip i mirë, por ne nuk do të shkojmë të fjetur. Thjesht, na duhet fitorja dhe për të duhet luftuar", ka thënë Khalid.

Interesante do të jetë edhe gara për mbijetesë ku tri skuadra, Flamurtari, Drenica dhe Ballkani, do të tentojnë të mos bien në pozitën e barazhit, derisa Trepça '89 dhe Gjilani shpresojnë se do t'i fitojnë ndeshjet e fundit dhe mbijetesën ta sigurojnë drejtpërdrejt. Dy skuadrat që bien drejtpërdrejt nga Superliga janë Liria e Prizrenit dhe KEK-u.

Sot zhvillohen shtatë ndeshjet në Ligën e Parë, nesër një

Shtatë ndeshje të javës së fundit në Ligën e Parë do të zhvillohen sot (e shtunë), kurse nesër (e diele) zhvillohet një ndeshje. Besa e Pejës kërkon inkuadrim në elitë, por e pret një ndeshje shumë e vështirë në Hogosht ndaj Kikës, e cila kërkon tri

pikët e plota për të shpresuar në mbijetesë. Përveç Kikës, edhe skuadra e fundit në tabelë, Bashkimi, shpreson të sigurojë një vend të barazh. Ndërkohë Vllaznia e Pozharanit dhe Ramiz Sadiku që janë në pozitën e barazhit do të tentojnë fillimisht t'i ruajnë pozitën aktuale e më pas synim kanë ta shfrytëzojnë mbetjen në elitë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Të gjitha ndeshjet fillojnë në orën 16:00.

IPKO SUPERLIGA

Të dielën takohen:
Ferizaj - Gjilani
Trepça '89 - KEK-u
Feronikeli - Prishtina
Flamurtari - Llapi
Ballkani - Drita
Liria - Drenica

TABELA

		PIKË
1. Feronikeli	32	77
2. Prishtina	32	75
3. Llapi	32	69
4. Drita	32	48
5. Ferizaj	32	43
6. Flamurtari	32	42
7. Drenica	32	40
8. Ballkani	32	40
9. Trepça '89	32	39
10. Gjilani	32	38
11. Liria	32	28
12. KEK-u	32	1

LIGA E PARË

Të shtunën takohen:
2 Korriku - Ramiz Sadiku
Fushë Kosova - Vitia
Dukagjini - Drenasi
Arbëria - Istogu
Vllaznia - Trepça
Vëllaznimi - Bashkimi (K)
Kika - Besa
Onix - Vushtrria

TABELA

		PIKË
1. Vushtrria	29	69
2. Besa	29	58
3. Dukagjini	29	56
4. Vëllaznimi	29	54
5. Vitia	29	47
6. Trepça	29	38
7. Istogu	29	38
8. Onix	29	37
9. Fushë Kosova	29	35
10. 2 Korriku	29	35
11. Arbëria	29	34
12. Drenasi	29	33
13. Vllaznia	29	31
14. Ramiz Sadiku	29	30
15. Kika	29	29
16. Bashkimi (K)	29	29

SHKURT

Kryetari i Trepçës '89 kërkon të dënohet Drita

Kryetari i skuadrës së Trepçës '89, Abedin Zeka, është shumë i sigurt se lojtari i Dritës, Ardit Mustafa, nuk ka pasur të drejtë loje në ndeshjen ndaj Flamurtarit. Zeka ka kërkuar nga Komisioni i Garave dënim ndaj Dritës, sipas nenit 56 të Garave të FFK-së. "Drita për interesa të veta e ka inkuadruar një lojtar të vitit 2001 në ndeshje. Lojtari në fjalë nuk ka qenë i licencuar për gara të Superligës. Ai nuk figuron në listën e Dritës të paraqitur për licencim. Ankesën e kemi bërë të enjten në orën 16:25. Ne jemi të sigurt për atë lojtar dhe besojmë se organet e drejtësisë do ta dënojnë Dritën me heqjen e nëntë pikëve. Nëse kjo nuk ndodh ne do të ankojemi në instancat më të larta të UEFA-s", ka deklaruar Zeka për "Olle".

Besa mobilizohet për ndeshjen ndaj Kikës

Klubi i Besës nga Peja ka bërë mobilizim të madh në tentim për t'u rikthyer në Superligën e Kosovës. Besa do ta luajë të shtunën ndeshjen e fundit kampionale, të vlefshme për javën e 30 të Ligës së Parë ndaj Kikës. "Mobilizim i gjithëmbarsuem i të gjitha figurave të sportit pejan që kontribuuan ndër vite për Besën. Ata u organizuan me besa-besë për të bërë të pamundurën që Besa të shtunën ndaj KF Kika t'i marrë tri (3) pikë vendimtare dhe të inkuadrohet në Superligë", thuhet në njoftimin e Besës.

Tottenhami kërkon dyshen shqiptare Strakosha - Hysaj

Dy lojtarët e Kombëtares së Shqipërisë, Elseid Hysaj dhe Thomas Strakosha, në verë mund t'i bashkohen Tottenham Hostpurit gjatë afatit kalimtar të verës. Lajmi është bërë me dije nga "FourFourTwo". Strakosha shihet si zëvendësues i Hugo Lloris, i cili mund të transferohet në Francë te PSG-ja, kurse Hysaj do ta zëvendësonte Kieran Trippierin. Mbrojtësi anglez pëlqehet nga disa skuadra, përfshirë edhe Napolin dhe Juventusin.

Juve shkarkon Allegrin

TORINO, 17 MAJ - Juventus e ka shkarkuar trajnerin Massimiliano Allegri i cili ishte pjesë e "Zonjës së Vjetër" që gjashtë vjet. Mossuksesi në Ligën e Kampionëve dhe Kupën e

Italisë duket se ka qenë vendimtar për të ardhmen e Allegrit, i cili gjatë kohës sa e drejtoj Juventusin arriti të fitojë pesë tituj të kampionit, katër Kupa dhe dy Superkupa. Sot (e shtunë)

në orën 14:00 do të jetë konferenca e lamtumirës për Allegrin, kurse Juventus ka filluar të mendojë për pasardhësin e tij. Ndërsa në listë për zëvendësimin e Allegrit, Juventus ka tre emra. I

pari në listë është trajneri aktual i Kombëtares së Francës, Didier Deschamp, pastaj trajneri i Tottenham Hotspurit, Mauricio Pochettino dhe Simone Inzaghi i Lazios.



Reali parakalon Unitedin, por dominon Anglia

Madrid, 17 maj - Manchester Unitedi është arritur dhe parakaluar nga Real Madridi si marka më e vlefshme e futbollit në botë, por klubet e Premierë Ligës ende e dominojnë renditjen e dhjetë më të mirëve. Sipas raportit më të fundit të "Brand Finance", Reali e kryeson listën për herë të parë në gati një dekadë. Klubi mbretëror madrilen mund të ketë pasur një sezon për t'u harruar në fushën e blertë, duke mos fituar dot asnjë trofe, i eliminuar që në 1/8 finale të Ligës së Kampionëve, por ende vlerësohet me 1.44 bilionë stërlina. Real Madridi ka pasur një rritje prej 27 përqindësh, ndërsa "Djajtë e Kuq" pësuan një rënie prej 6 përqindësh. Klubi i "Old Trafford" tani vlerësohet 1.29 bilion stërlina. Edhe pse mbetet një nga gjigantët e futbollit evropian, Unitedi vazhdon të luftojë për të qenë në majë, pas largimit të trajnerit Sir Alex Ferguson. Sipas studimit, një arsye për rënien si "brand" (markë) e tij është stili i mërzitshëm i futbollit. "Djajtë e Kuq" renditen vetëm të 18-tët në pëlqimet për t'u parë duke luajtur. Shkarkimi i një trajneri (Mourinho), eliminimi që në çerekfinale të Ligës së Kampionëve dhe mbyllja jashtë zonës "Champions" në Premierë Ligë nuk i ka ndihmuar ata. Unitedi e përfundoi kampionatin në vendin e



gjashtë të renditjes, duke munguar në kompeticionin madhor të klubeve evropiane, sezonin e ardhshëm. Po ashtu, regjistroi një rekord mjaft negativ, duke humbur 8 nga 12 ndeshjet e fundit në të gjitha garat. Ndërkohë, Barcelona ka shënuar një rritje 12 për qind krahasuar me sezonin e kaluar, për t'u ngjitur në vlerën 1.22 miliard stërlina. Katalanasit mbajnë vendin e tretë në këtë renditje, raporton "Telesport". Bayern Muncheni u rendit i katërti, me 1.15 miliard stërlina, duke shënuar një rritje prej 13 përqindësh si "brand". Kampionët e Premierë Ligës, Manchester City, zbriti në vendin e pestë, me vlerën 1.1 miliard stërlina. Pas një tjetër sezoni të pabesueshëm, Liverpooli pa rritje prej 20 përqindësh në vlerën

e vet, duke u ngjitur në klasifikim. "Reds" vlerësohet 1.04 miliard stërlina si "brand". Finalistja e "Europa League", Chelsea, pësoi një rënie të vogël, me gati 2 për qind, pasi vlera e tij zbriti në 846 milionë stërlina. PSG-ja u ngjit në klasifikim me një rritje prej 21 përqindësh. Vlera e tij llogaritet 799 milionë stërlina, por ky është lajm i keq për Arsenalin, që parakalohet nga kampionët e Ligës 1. "Topçinjtë" humbën një për qind të vlerës së tyre si "brand", për t'u renditur pas PSG-së, me 773 milionë stërlina. Rivali i tyre në veri të Londrës, Tottenhami, shënoi një rritje masive. "Spurs" llogaritet 20 për qind më shumë se vitin e kaluar, por vetëm ka ruajtur vendin në "top 10", me vlerën 662 milionë stërlina.

Golden State fitoi edhe përballjen e dytë ndaj Portlandit

OAKLAND, 17 MAJ - Fitore me përmbyseje e Golden State Warriorsit ndaj Portland Trail Blazersit në ndeshjen e dytë finale të Konferencës së Perëndimit, me rezultatin e serisë që thellohet në 2-0. Në "Oracle Arena" sfida u mbyll 114-111 për kampionët në fuqi të NBA-s, që rikuperuan plot 17 pikë diferencë, të krijuar në favor të Blazersit pak para se të mbyllej pjesa e parë. Warriorsi shpërtheu në fillim të periodës së tretë me tre trepikësha radhazi dhe me një rezultat të pjesshëm 13-0 e ngushtoi diferencën në 66-69, për të marrë më pas epërsinë në fund të këtij 12-minutëshi. Në periodën e fundit pati luftë të ashpër mbi parket, por vendësit, falë edhe mbështetjes së publikut në "Oracle Arena", triumfuan me 3 pikë më shumë.

Edhe pse mungonte Kevin Durant, një nga më të mirët e skuadrës së Steve Kerr, Warriorsi u udhëhoq nga Steps Curry, që realizoi plot 37 pikë, dha 8 asistime dhe rikuperoi tetë topa, ndërsa Klay Thompson shtoi edhe 24 pikë të tjera për vendësit. I



rëndësishëm edhe "double-double" i Draymond Greenit, që firmosi 16 pikë e 10 rikuperime, ndërsa për Blazersin nuk mjaftuan 23 pikët e 10 "reboundet" e Damian Lillardit dhe 22 pikët e CJ McCollumit. Tashmë

takimi i tretë i serisë finale do të zhvendoset në "Moda Center" të Portlandit, ku Blazersi duhet ta marrë revanshin, për të shpresuar te kualifikimi në finalen e madhe të NBA-së.

SHKURT

Prestoni interesohet për Muriqin

Skuadra angleze Preston North End, që bën pjesë në kampionatin anglez, ka treguar interesim për portierin e Kosovës dhe Manchester Cityt, Arijanet Muriqi. "The Sun" ka njoftuar se City është e interesuar ta huazojë portierin shqiptar, pasi nga lëndimi është rikthyer Claudio Bravo. Muriqi është futur në formacionin më të mirë të vitit për lojtarët nën moshën 21-vjeçare nga "Goal.com".

Casillasi mohon lajmin për pensionim

Portieri i Portos, Iker Casillas, ka hedhur poshtë lajmin se ai do të pensionohet pas datës 25 maj, në finalen e Kupës së Portugalisë, që Porto do të luajë ndaj Sportingut të Lisbonës. Ikona e Real Madridit ka thënë se kur të vijë koha do ta bëjë publik lajmin për pensionim. "Tërheqja? Do të vijë dita që do të tërhiqem. Do ta publikoj lajmin në momentin që ajo kohë do të vijë. Për momentin, qetësi. Dje kam pasur një vizitë me doktorin Filipe Macedo dhe gjithçka është mirë. Ky është një lajm i mirë që dua ta ndaj me të gjithë", ka shkruar Casillas në "Twitter".

De Jong, lojtari i vitit në Holandë

Kampionati holandez i sezonit ka shpallur të gjitha verdiktet e këtij sezoni, kurse kryefjala mban emrin Ajax. "Harkëtarët" fituan titullin dhe Kupën, ndërsa golashënues u shpallën Tadiçi i Ajaxit dhe De Jongu i PSV-së me nga 28 gola. Po ashtu, është zgjedhur edhe futbollisti më i mirë i këtij sezoni, i cili është Frankie De Jong. 22-vjeçari ishte truri i lojës së bukur të Ajaxit, ndërsa sezonin e ri do të luajë për Barcelonën. De Jongu e mbylli kampionatin me 3 gola të shënuar dhe po kaq asistime të dhuruara, por shifrat e vogla nuk kanë shumë rëndësi përballë një lojtari me cilësi të tilla.

Barça nuk llogaritet në Umtitin

Barcelona nuk e ka në planet e veta, për edicionin e ri, Samuel Umtitin. Lajmi është bërë me dije nga mediet në Spanjë, kurse tashmë kanë filluar të publikohen edhe emrat e skuadrave që e dëshirojnë mbrojtësin francez. Tri skuadrat e Premierë Ligës, Manchester City, Manchester Unitedi dhe Arsenali si dhe Juventus nga Serie A dhe PSG-ja nga Liga 1. Vlera e reprezentuesit të Francës vlerësohet rreth 60 milionë euro.

Dzeko i thotë "po" Interit

Sulmuesi Edin Dzeko është shumë pranë transferimit të Interit. Sipas asaj që shkruan "Gazzetta dello Sport", sulmuesi boshnjak, në fund të sezonit, pasi të jetë mbyllur edhe çështja e Ligës së Kampionëve, do të ulet në tavolinë me drejtuesit e Romës, duke i kërkuar që të largohet. Boshnjaku i ka thënë "po" Interit dhe për këtë motiv duhet gjetur pajtimi sa më shpejt, pasi kontrata i skadon në vitin 2020 dhe zikaltrit nuk duan të paguajnë shumë para për kartonin e tij. Për Dzekon është gati kontrata për tre vjet, me një rrogë që mund të prekë 3.5 milionë euro në sezon.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

Prishtinë, 18/05/2016

Mbështetur në Ligjin për Shërbimin Civil Nr.03/L-149, Rregullore nr. 21/2012 Për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë, Rregulloren Nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, shpall:

SHPALLJE **KONKURS I BRENDSHËM -AVANCIM**

Procedura e konkurrimit është e hapur vetëm për nëpunës të KKTK-së.

Titulli i punës : Udhëheqës i Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme
Nr. Ref.: RN00004888

Koeficienti: 9

Procedura e aplikimit: I brendshëm

Lloji i pozitës: E karrierës

Orët e punës: 40 orë në javë

Vendi i punës: Kompleksi Rilindja, kontejneri nr.3 Prishtinë

Nëpunësi raporton te : Drejtori i Departamentit për Trashëgimi Kulturore dhe Shërbime të Përgjithshme

Qëllimi i vendit të punës

Udhëheqës i Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme është përgjegjës për koordinimin dhe ofrim të efektshëm të shërbimeve të përgjithshme administrative për institucionin, të burimeve njerëzore, legjisllacion, teknologji informative.

Detyrat dhe përgjegjësit kryesor:

1. Udhëheqë punën e gjithmbarshme të njësisë dhe ndihmon mbikëqyrësin në caktimin e objektivave dhe hartimin e planit të punës për përbushjen e këtyre objektivave ;
2. Menaxhon stafin e divizionit dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit ;
3. Ndihmon mbikëqyrësin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të ngritjes së efikasitetit në punë;
4. Siguron zbatimin e legjisllacionit ligjore lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e burimet njerëzore;
5. Ofron përkrahje në hartimin e legjisllacionit parësor dhe dytësor nga fushëveprimi i institucionit dhe siguron respektimin e teknikave dhe standardeve të hartimit të legjisllacionit;
6. Menaxhimi i të gjitha çështjeve që ndërlidhen me burimet njerëzore, legjisllacion, teknologjinë informative si dhe shërbimeve tjera administrative për institucion;
7. Ofron ndihmë dhe siguron mbështetje administrative dhe siguron rrjedhën e informatave të duhura dhe koordinimin e çështjeve administrative;
8. Bën vlerësim të rregull të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara.

Shkathësit e kërkuara:

- Njohuri në burimet njerëzore, legjisllacion, teknologjinë informative si dhe shërbimeve tjera administrative
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim
- Shkathësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë
- Shkathësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access)
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor
- Diplomë universitare e preferuar në: menaxhment biznes, ekonomi, teknologji informative
- Minimum 5 vite përvojë pune

Dorëzimi i aplikacioneve

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Kompleksi Rilindja, kontejneri nr.3 kati i II (dytë) zyra nr.206, Prishtinë, Kosovë. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni Tel: +383 (0) 38 211 617, prej orës 08:00-16:00. Konkursi është i hapur nga data 18.05.2019 deri më datë 25.05.2019.

Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune për të cilin konkurroni. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e shkurtër do të kontakohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

Priština, 18.05.2019

Na osnovu Zakona o Civilnoj Službi br. 03/L-149, Uredbe br. 21/2012 o Avanciranju u Karijeri Civilnih Službenika, Uredbe br. 02/2011 o Proceduri Rekrutiranja u Civilnoj Službi Republike Kosova, Savet Kosova za Kulturno Nasleđe objavljuje:

OGLAS **INTERNI KONKURS - AVANCIRANJE**

Procedura konkurisanja je otvorena samo za službenike SKKN-a.

Naziv posla: Rukovodilac Divizije za osoblje i opšte službe

Br. Ref.: RN00004888

Koeficijent: 9

Procedura apliciranja: Interna

Vrsta pozicije: Karijerna

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Radno mesto: Kompleks Rilindja, Kontejner br. 3 Priština

Službenik izveštava: Direktor Departmana za kulturno nasleđe i opšte službe

Svrha radnog mesta

Rukovodilac Divizije za osoblje i opšte službe je odgovoran za koordinaciju i efikasno pružanje opštih administrativnih usluga za instituciju, ljudske resurse, zakonodavstvo i informacione tehnologije.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

1. Rukovodi celokupnim radom jedinice i pomaže nadzorniku u postavljanju ciljeva i izradi plana rada za ispunjenje ovih ciljeva;
2. Upravlja osobljem divizije i organizuje posao dodeljivanjem dužnosti podređenima, pruža uputstva i prati rad osoblja;
3. Pomaže nadzorniku u proceni internih procesa i procedura i preporučuje promene/poboljšanja u cilju povećanja efikasnosti u radu;
4. Obezbeđuje sprovođenje pravnog zakonodavstva vezano za upravljanje i razvoj ljudskih resursa;
5. Pruža podršku u izradi primarnog i sekundarnog zakonodavstva iz delokruga institucije i obezbeđuje uskladenost sa tehnikama i standardima izrade zakonodavstva;
6. Upravlja svim pitanjima vezanim za ljudske resurse, zakonodavstvo, informacione tehnologije i druge administrativne usluge za instituciju;
7. Pruža pomoć i obezbeđuje administrativnu podršku i obezbeđuje protok odgovarajućih informacija i koordinaciju administrativnih pitanja;
8. Vršiti redovnu procenu osoblja pod njegovim nadzorom i podržava njihov razvoj putem obuke kako bi se osiguralo izvršavanje njihovih dužnosti na nivou traženih standarda.

Zahtevane veštine:

- Poznavanje ljudskih resursa, zakonodavstva, informacionih tehnologija i drugih administrativnih usluga
- Sposobnost komunikacije, pregovaranja i uveravanja u upravljanju
- Veština u postavljanju ciljeva, planiranju rada i analizi
- Veština rukovođenja i organizacije tima, sposobnost upravljanja timom ili radnom grupom
- Veština rada na računaru sa programskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access)
- Da ima sposobnost da efikasno radi u multi-etničkom i multi-kulturalnoj sredini
- Preferirana univerzitetska diploma iz: poslovnog upravljanja, ekonomije, informacionih tehnologija
- Najmanje 5 godina radnog iskustva

Dostavljanje aplikacija

Savet Kosova za Kulturno Nasleđe, Kompleks Rilindja, kontejner br. 3 sprat II (drugi) kancelarija br. 206, Priština, Kosovo. Za detaljnije informacije možete se obratiti na tel: +383 (0) 38 211 617, od 08:00 do 16:00 časova. Konkurs je otvoren od 18.05.2019 do 25.05.2019.

Civilna služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i očekuje aplikacije od svih osoba muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu.

Aplikacije dostavljene nakon isteka predviđenog roka se neće prihvatiti. Uz aplikaciju priložiti kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i drugu potrebnu dokumentaciju, koja se traži za radno mesto za koje konkurirate. Samo odabrani kandidati sa spiska uže izbora će biti kontaktirani.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror
Državna Komisija za Obeležavanje i Održavanje Državne Granice
State Commission for Demarcation and Maintenance of State Borders

Bazuar në nenin 12, paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në Vendimin e Qeverisë nr. 01/04, të datës 22.09.2017 mbi emërimin e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, Vendimin e Qeverisë nr.01/91, të datës 26.02.2019, si dhe Vendimin e Qeverisë me nr.04/101 të datës 02/05/2019, për plotësim ndryshim në vendimet 01/04, KSHSHMKSH bënë:

Shpallje të Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit:	Zyra e Kryeministrit
Njësia Organizative:	Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror
Titulli i punës:	Ekspert
Numri i referencës:	KSHSHMKSH-01/MSHV
Tarifa e shërbimit:	Sipas vendimit të Qeverisë nr.01/91, të datës 26.02.2019
Raporton :	Kryesuesit të KSHSHMKSH-së
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Gjashtë (6) muaj
Orari i punës:	I plotë
Numri i ekzekutuesve:	I (një)
Vendi:	Prishtinë

Detvat dhe përgjegjësitë e të angazhuarit për MSHV:

- Ndihmon në hartimin dhe zbatimin e projekteve në lidhje me platformen e demarkimit të kufirit;
- Ndihmon në hartimin dhe zbatimin e projekteve në lidhje me korigjimin e kufirit me Malin e Zi bazuar në dokumentin e nënshkruar nga dy presidentet;
- Bënë mbledhjen, sistematizimin dhe analizën e dokumenteve relevante që kanë të bëjnë me identifikimin e kufirit shtetëror të Kosovës me shtetet fqinjë;
- Koordinon bashkpunimin e KSHSHMKSH me institucionet relevante, sidomos të atyre që merren me aspektet ingjinerike;
- Bënë hulumtimin e fondeve në arkivat e ndryshme brenda dhe jashtë vendit, për projektet ingjinerike që prekin kufirin;
- Bënë identifikimin e vijës së kufirit në terren bazuar në hartat e ndryshme;
- Ofron informata për stafin brenda KSHSHMKSH për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësitë të tyre;
- Kryen çdo detyrë tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;
- Harton raporte me shkrim për KSHSHMKSH.

Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë universitare në fushat ingjinerike
- 10 vite përvojë pune në lëmitë ingjinerike
- Të ketë përvojë në negociata ndërshtetërore për ndikimet e mundshme në territorin e Kosovës apo te shtetit fqinjë me Kosovën
- Të ketë përvojë në identifikimin e vijës kufitare ndërshtetërore, vendosjen e shenjave kufitare dhe nderimin e objekteve të infrastrukturës
- Te ketë njohuri për projektet ingjinerike të cilat mund të ndikojnë në kufijtë ndërshtetëror.
- Të ketë njohuri për objektet hidroteknike ndikimi i të cilave shtrihet në territorin e shteteve fqinje apo te shteteve fqinje në territorin e Kosovës
- Të ketë njohuri për planet afatgjata ingjinerike të cilat mund të kenë ndikim jashtë kufijve të Kosovës.
- Të ketë njohuri për dokumentacioni tekniko shkencor me vlerë të përhershme
- Aftësi shumë të mira në të shkruar dhe komunikim të një nga gjuhët zyrtare. Përparësi është njohja e gjuhëve të shteteve fqinjë.
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për fushat përkatëse;
- Shkathësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathësi hulumtues, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët e interesuar për angazhim, për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Ø CV-në;
- Ø Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës, referenca dhe çdo dokument tjetër i cili demonstroi dhe vërtetoi përmbushjen e kriterëve të fushës përkatëse);
- Ø Kopje të letërnjoftimit.

Dokumentacionet duhet të jenë në pliko (zarf) të mbyllur ku duhet të specifikohet pozita për të cilën aplikohet dhe të dorëzohen në Zyrën e Komisionit Shtetëror për Shënjimin e Kufirit Shtetëror/ Zyrën e Kryeministrit, sheshi Nëna Tereze, Ndërtesa e Qeverisë, kati IV, zyra nr. 405 ose përmes postës, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim.

Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Kompensimi është i sipas vendimit të Qeverisë nr.01/91, të datës 26.02.2019.

Zyra e Komisionit Shtetëror për Shënjimin e Kufirit Shtetëror/ZKM, mirëpret aplikimin nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit: **038 200 14 999**

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për listën e ngushtë.

Afati i aplikimit është i hapur 8 ditë nga data e publikimit, nga data 18/05/2019 deri më datën 24/05/2019.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror
Državna Komisija za Obeležavanje i Održavanje Državne Granice
State Commission for Demarcation and Maintenance of State Borders

Na osnovu člana 12, stav 4 Zakona br. 03/L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo, na osnovu Zakona br. 04/L-077, O obligacionim odnosima, Odluke Vlade br. 01/04, od 22.09.2017. o imenovanju Državne komisije za obeležavanje i održavanje državne granice, Odluke Vlade br. 01/91 od 26.02.2019. kao i Odluke Vlade br. 02/05/2019, za dopunu i izmenu odluke 01/04, DKOODG vrši:

Objavljivanje javnog konkursa za Sporazum o posebnim uslugama

Naziv ustanove:	Kancelarija premijera
Organizaciona jedinica:	Državna komisija za obilježavanje i održavanje državne granice
Naziv posla:	Ekspert
Referentni broj:	DKOODG-01/SPU
Naknada za uslugu:	Prema Odluci Vlade br. 01/91 od 26.02.2019
Izveštava :	Predsednik DKOODG-e
Vrsta ugovora:	Sporazum o posebnim uslugama - (SPU)
Trajanje ugovora:	Šest (6) meseci
Radno vrijeme:	Puno radno vreme
Broj izvršilaca:	1 (jedan)
Mesto:	Pristina

Dužnosti i odgovornosti angažovanih SPU:

- Pomaže u osmišljavanju i realizaciji projekata vezanih za platformu demarkacije granice;
